

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Eri MURATI  
Zv/kryeredaktorë - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIII - Nr. 7647 E hënë 10 Shtator 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Dje

në "Deutsche Welle"

Nga ADELHEID FEILCKE

Ishte vërtetë kaq afër zgjidhja? Përse u fol kaq shumë për një ujdi të afërt Kosovë-Serbi, për shkëmbim territoresh? Kur dy politikanë e duan një zgjidhje së bashku...  
Vijon në faqen 18

Teatri politik e cinik për Kosovën vazhdon...



Opinion

Ditës

Nga SPARTAK NGJELA

Vuçiç nuk u lejua të shkojë në Drenicë. Ai donte të fyente luftën çlirimtare të Kosovës. Por burrat kosovarë i treguan vendin. Ata i thanë: "Zoti Vuçiç, Adem..."  
Vijon në faqen 19

Shqiptarë, rri në qetë!  
Kosova ka ende burra



INTERVISTA

Sekretari organizativ flet për riorganizimin e PD

## Zgjedhjet lokale, Bozdo: PD, aleancë mbipolitike për t'i bërë ballë Ramës

"Partia Demokratike me njerëz të aftë, PS e armatosur me krim"

Nga VALENTINA MADANI

Demokratët rinisin brenda kësaj jave zgjedhjet e brendshme, të cilat pritet të përfundojnë në fund të muajit tetor. Sekretari organizativ i PD-së, Enno Bozdo e konsideron procesin e zgjedhjeve të brendshme si të rëndësishëm në riorganizim strukturor; i ndërmarrë...  
Në faqet 2-3

## FLET DREJTUESJA E INAS: SI TE KRYENI VERIFIKIMIN E VITEVE TE PUNES, AFATET

# ALIAJ: PENSIONET E PLEQERISE, KONTRIBUTET E PERLLOGARITJA

Ekspertja e Institutit Nacional të Asistencës Sociale: Shembuj konkretë, bazuar në koeficientet e indeksimit. Pagat e indeksuara nga viti 1994-2015



(Në foto) Drejtuesja e INAS, Beskida Aliaj

Në faqet 6-7

DY PRESIDENTET

Takimi Meta-Thaçi: Dialogu me Serbinë garanton të ardhmen në BE të të dyja vendeve

Në faqen 4

DENONCIMI

Mori 8 mijë euro për një çështje gjyqi, lihet në burg juristi i Hipotekës së Korçës

Në faqen 5

DY MINORENE NE KERMIM

Grabitja e katedrales në Korçë, prokuroria lëshon 5 urdhërarreste, prangosen tre të rinj

Në faqen 9

ARRESTOHET 52-VJEÇARI

Operacionet antidrogë, në 10 muaj u kapën 8 tonë marijuanë në kufi, dje u kapën 20 kilogramë

Në faqen 8

PROTESTAT, REAGON EDHE BE



Presidenti Vuçiç: Nuk e njohim pavarësinë e Kosovës. Haradinaj i anulon lejen e dhënë

Në faqet 10-11

Mjeku urolog: Hematuria mund të jetë shenjë e një kanceri të avancuar

## Rezar Rusi: Urinimi me gjak, paralajmërim serioz

Ylli Merja: Përzjerja bimore që do të luftojë dhimbjet e gjurit

Nga VOLTIZA DURO

Prania e gjakut në urinë mund të jetë një paralajmërim i çrregullimeve serioze në organizëm. Në një intervistë për suplementin "Life Pages" në "Gazeta Shqiptare", mjeku urolog dr. shk. Rezar Rusi tregon se



problemet me veshkat apo infeksionet e ndryshme mund të jenë shkaktarët kryesorë të sëmundjes së njohur si hematuria. Më tej urologu thekson se kjo sëmundje mund të jetë shenjë e një kanceri të avancuar të veshkës, vezikës ose prostatës. Ndërkohë...

Suplement

# STRATEGJIA E OPOZITËS

## INTERVISTA

Valentina Madani

**D**emokratët rinisin brenda kësaj jave zgjedhjet e brendshme, të cilat pritet të përfundojnë në fund të muajit tetor. Sekretari organizativ i PD-së, Enno Bozdo e konsideron procesin e zgjedhjeve të brendshme si të rëndësishëm në riorganizim strukturor, i ndërmarrë në këto vite të Partisë Demokratike në opozitë. Bozdo thotë për "Gazeta Shqiptare" se synohet të vihen në krye të strukturave individë, të cilët vlerësohen dhe kanë kontribute të prekshme politike dhe qytetare. Por, paralel me zgjedhjet në parti do të nisë edhe procesi i propozimeve nga anëtarësia për kandidatët që do garojnë në zgjedhjet e ardhshme lokale. Sipas zyrarit të lartë të PD-së, ky mekanizëm siguron kohezion, konsultim të gjerë dhe të detyrueshëm si dhe gjithëpërfshirje në vendimmarrje. Përballë një qeverie të lidhur me krimin, Bozdo thekson se: "PD duhet të përzgjedhë njerëzit e saj, të cilët duhet të kenë merita reale politike dhe qytetare. Duhet të jenë kontributorë në PD, por edhe qytetarë dhe familjarë model".

**Z.Bozdo, pas ndryshimeve në statut dhe me afrimin e zgjedhjeve lokale, Partia Demokratike do të nisë procesin zgjedhor fillimisht në nivel degësh dhe më pas drejt qendrës. Në çfarë faze është ky proces dhe sa kohë do të marrë deri në mbijlljen e tij?**

Ky është procesi më i rëndësishëm në riorganizim strukturor, i ndërmarrë në këto vite të Partisë Demokratike në opozitë. Konceptet e reja të riorganizimit janë debatuar dhe mbështetur gjerësisht nga struktura në nivele të ndryshme të saj, duke u shtjelluar qartë në statutin e ri të Partisë Demokratike. Konceptet e reja do të sjellin jo vetëm zhërvjellësim të strukturës dhe mbulim më të mirë të territorit, por edhe përgjegjësi konkrete dhe sistem të strukturuar të meritës dhe karrierës brenda partisë. Procesi do të fillojë brenda kësaj jave dhe do të përfundojë në fund të tetorit.

**Mbi çfarë kritereesh po zgjidhen kandidatët për drejtues të rinj në degët e PD-së?**

Procesi i tërheqjes së propozimeve nga anëtarësia do të jetë i hapur, transparent dhe i dokumentuar. Ky proces që do të zhvillohet paralelisht me zgjedhjen në strukturave, do të synojë promovimin e njerëzve më të aftë, më cilësorë dhe më të vlerësuar nga demokratët.

Sekretari organizativ flet për riorganizimin e PD: Kandidatët, sipas meritës dhe kontributeve

# "Lokalet", Bozdo: PD, aleancë mbipolitike për t'i bërë ballë Ramës

## "PD me njerëz të aftë, PS e armatosur me krim"



Sekretari organizativ i PD-së, Enno Bozdo

### KANDIDATËT

"Ky mekanizëm prezantohet për herë të parë në parti të politike në Shqipëri dhe është shumë i ngjashëm me atë të përdorur nga konservatorët britanikë. Mekanizmi merr realisht në konsideratë mendimin e anëtarësive, duke e kuantifikuar atë dhe sigurisht duke e filtruar, me qëllim përzgjedhjen e kandidatëve më cilësorë".

Nërdëkaq, standardi i kërkuar dhe i domosdoshëm që ka lidhje me eksperiencën, kontributin dhe qëndrueshmërinë politike nuk ka ndryshuar. Kështu, ne synojmë të nxjerrim në krye të strukturave tona individë, të cilët vlerësohen dhe kanë kontribute të prekshme politike dhe qytetare.

**Pas zgjedhjeve në bazë, si do të vijojë procesi në qendër? Cilat nga strukturat e PD-së do të rizgjidhen?**

Të gjitha strukturat e Partisë Demokratike do të rizgjidhen. Këshilli Kombëtar e më pas kryesia e re dhe departamentet e Partisë Demokratike.

**Po përsa i përket përzgjedhjes së kandidatëve për drejtues të rinj të bashkive?**

Në të njëjtën kohë do të merren propozimet edhe për kryetarët e ardhshëm të bashkive dhe këshilltarët bashkiakë. Edhe këtu kemi të bëjmë me një risi: një mekanizëm i përcaktuar qartë

në statutin e Partisë Demokratike. Ky mekanizëm prezantohet për herë të parë në parti të politike në Shqipëri dhe është shumë i ngjashëm me atë të përdorur nga konservatorët britanikë. Mekanizmi merr realisht në konsideratë mendimin e anëtarësive dhe e kuantifikuar atë dhe sigurisht duke e filtruar atë, me qëllim përzgjedhjen e kandidatëve më cilësorë.

**A ka një 'shteg' në statusin e ri të partisë, për të diktuar kandidatët për 61 bashkitë, duke shmagur organet e partisë dhe rrymat që vijnë nga baza? Procedurat e reja për zgjedhjen e kandidatëve, parashikuar në statutin e ndryshuar të PD, a do të jenë të vlefshme dhe do të veprojnë vetëm për kandidatët për deputetë dhe jo për kandidatët për kryetar bashkie?**

Asnjë shteg. Pasi të merret mendimi i anëtarësive së gjerë, kandidatërat do të shqyrtohen në kryesinë e

### ZGJEDHJET

"Konceptet e reja do të sjellin jo vetëm zhërvjellësim të strukturës dhe mbulim më të mirë të territorit, por edhe përgjegjësi konkrete dhe sistem të strukturuar të meritës dhe karrierës brenda partisë. Procesi do të fillojë brenda kësaj jave dhe do të përfundojë në fund të tetorit", tha z.Bozdo.

partise dhe më pas do të miratohen në Këshillin Kombëtar. Praktikisht janë organet kryesore që vendosin dhe jo individët. Këtu rregulli i nënshtrohet të gjitha llojet e kandidatëve, qoftë për pushtetin vendor apo qendror. Ky mekanizëm siguron kohezion, konsultim të gjerë dhe të detyrueshëm si dhe gjithëpërfshirje në vendimmarrje.

**Ky proces zhvillohet në një kohë që PD përgatitet për zgjedhjet lokale e kur përballë sipas saj qëndron një qeveri e kriminalizuar e të korruptuar dhe larg interesave të shqiptarëve...**

Kriminalizimi i politikës dhe i shoqërisë shqiptare nuk është aksidenti. As edhe pasojë e një njeriu të paafte dhe mediokër, siç mund t'i duket dikujt kryeministri ynë. Kriminalizimi është një strategji e mirëfillte dhe e mirëprogramuar nga Edi Rama qysh në ditën zero të qeverisë së tij. Rama ka treguar "gjenialitet" të veçantë për të programuar dhe realizuar kriminalizimin e politikës, të qeverisjes së tij, të organeve vendore dhe zyrate kryesore të shtetit. Kërkon talent malinjë dhe dashakeqësi shembullorë për t'ia shkaktuar këtë gjëmë vendit tënd. Kërkon guxim dhe vendosmëri të negociosh dhe të ulesh në tavolinë me bandat

më të rrezikshme. Kërkon cilësi të jashtëzakonshme t'i menaxhosh këto banda, t'i mbash nën kontroll, t'i bësh të të shërbejnë sa herë ka zgjedhje, por edhe të ndash plaçkën e luftës me to. Kjo të lë me gojë hapur! E këtu duhet të tregohemi të ndershëm me veten: këtu djali (ER) nuk i mungon aspak talenti, frymëzimi dhe vullneti. Është diabolike kjo që ai ka realizuar në Shqipëri. Është fenomeni i pandodhur në asnjë nga vendet e ish-blokut lindor, vende të cilat kanë kaluar në etapa të ngjashme historike. Hannah Arend, e ndodhur përballë një kriminalizimi të tillë të ngjashëm së Gjermanisë së Luftës së Dytë Botërore, ndërsa dëgjonte dëshminë e një hierarku nazist në gjyq, e cilësonte dikur këtë fenomen si "banaliteti i të keqes". Me Edi Ramën duhet të themi "gjenialiteti i së keqes". Ky djalë është gjenial, gjenial i së keqes, për fatin tonë të mbrapshtë. Në këtë panoramë "frymëzuese", PD duhet të përzgjedhë njerëzit e saj, që siç edhe cilësua pak më sipër, duhet

### QELLIMI

"Qëllimi i parë dhe thelbësor i PD-së është dekriminalizimi i politikës, vetingu i politikës, asgjësimi i krimit të organizuar, pastrimi i politikanëve të lidhur me krimin. Po ra krimi, ka rënë Rama. Po ra krimi, ka fituar shoqëria shqiptare e me të gjithashtu, Partia Demokratike!", tha z.Bozdo.

të kenë merita reale politike dhe qytetare. Duhet të jenë kontributorë në PD, por edhe qytetarë dhe familjarë model.

**Sikur ngjan paska si paradoksale...?**

Kushdo që e vështron me minimumin e ndershmerisë këtë situatë, e kupton se ndërsa Partia Demokratike flet për kontribute dhe qytetari, pala tjetër ndërton aleanca me krimin e organizuar. Apo më mirë, pala tjetër është vetë krimi i or-



ganizuar. Në këto kushte, besoj çdo diskutim për zgjedhje të ndershme dhe të drejta bie.

**Si mund të bëhet PD më fortë dhe më të gatshme për t'u përballur me qeverinë "Rama"?**

Ka një tendencë të gazetarisë për të trajtuar fenomenet politike në Shqipëri si çështje të përballjes normale politike të dy partive: PD dhe PS. Pra, si një konkurrencë reale mes programeve, lidhshpimit dhe strukturës të dy partive politike. Është njësoj sikur të shkosh për të luajtur një ndeshje të zakonshme futbolli dhe ekipi kundërshtar vjen në fushë me hunj dhe thika. Kështu shpjegohen edhe thirrjet triumfuese të Ramës dhe të të tujve mbi rezultatin e zgjedhjeve të ardhshme vendore. Janë të armatosur rëndë, me para, krim dhe drogë, me polici dhe administratë. Ndërsa nga PD pritet të futet në

fushë me njerëz, ide dhe programe elektorale!

**Atëherë si mund të bëhet shoqëria më e fortë dhe më e gatshme për t'u përballur me këtë lloj qeverie që ju përmendni...?**

Krimi nuk ka qenë, nuk është dhe nuk do të jetë kurë fenomen politik. Është fenomeni shoqëror që politika zgjedh si rregull ta luftojë, por si përjashtim edhe ta mbështesë. Kjo e fundit është rasti i politikës së 5 viteve të fun-





Kreu i PD: S'mjafton drejtësia për shkëputjen e lidhjeve të politikës me krimin

# Basha citon prokurorin e vrarë nga mafia: Pastrim brenda politikës

"Të flaken politikanët e afërt me mafien"

Valentina Madani

**P**D-ja dhe kreu i saj, Lulzim Basha duken të vendosur për finalizimin e objektivit të tyre, shkëputjen e politikës nga krimi i organizuar. Kryetari i PD, Lulzim Basha, postoi dje në "Facebook" një citim të gjyqtarit të vrarë nga mafia, Paolo Borsellino për të shpjeguar arsyen përse vetingu për ndarjen e politikës nga krimi është jetik. Sipas tij, është detyrë e institucioneve që të flakin politikanët e afërt me mafien. Borsellino ishte gjyqtar italian i vrarë me bombë nga mafia. Ai konsiderohet të jetë një nga magjistratët më të rëndësishëm të vrarë nga mafia siciliane dhe mbahet në mend si një nga simbolet kryesore të betejës së shtetit kundër mafies. Të dy, Borsellino dhe Falcone, u quajtën heronjtë e 60 viteve të fundit në botimin e revistës "Time" më 13 nëntor 2006. Dyzeteshtatë vetë u dënuan në lidhje me vrasjen e tij.



Kreu i PD-së, Lulzim Basha

**PAOLO BORSSELLINO**  
Borsellino ishte gjyqtar italian i vrarë me bombë nga mafia. Ai konsiderohet të jetë një nga magjistratët më të rëndësishëm të vrarë nga mafia siciliane dhe ai mbahet në mend si një nga simbolet kryesore të betejës së shtetit kundër mafies. Të dy, Borsellino dhe Falcone, u quajtën heronjtë e 60 viteve të fundit në botimin e revistës "Time" më 13 nëntor 2006. Dyzeteshtatë vetë u dënuan në lidhje me vrasjen e tij.

dit në Shqipëri. Është po kjo politikë që në vitin 2005 zgjodhi ta shfarosë krimin dhe e realizoi këtë objektiv. Tani, sigurisht PD-ja është pjesë e shoqërisë dhe udhëheq aksionin politik të saj, por shoqëria duhet të reagojë gjithashtu. Dhe që të reagojë duhet nxitur, duhet ngacmuar, duhet "pickuar". Nervi i saj duhet mpirë! Shoqëria duhet të reagojë jo për hir dhe për favor të PD-së, por për hir të vendit dhe të vetvetes. Armët politike për të luftuar krimin janë të limituara. I tillë ishte ligji i dekriminalizimit, ku PS-ja u detyrua ta pranonte me pahir.

**Cili është efekti?**  
I limituar për sa kohë kryeministri Edi Rama e nxori pjesërisht krimin nga xhepi i qeverisjes dhe e futi në xhepin e strukturës partiake të Partisë Socialiste.

**Ndërkohë, Partia Demokratike e ka "pickuar" shoqërinë për të reaguar fort? Ç'po bën ajo për mobilizimin e shoqërisë tek paralajmëron edhe mosbindje civile?**

Le të kthehemi tek Partia Demokratike. Ajo e ka bërë mirë punën e saj përsa i përket ekspozimit lakuriq të fenomenit të kriminalizimit dhe të korrupsionit. Ajo ka thërritur protesta të shumta kundër drogës, krimit dhe korrupsionit. Ajo ka kërkuar edhe mosbindje civile. Ajo ka mobilizuar ç'ka mundur dhe ka kërkuar reagimin e ndërkombehtarëve dhe të shoqërisë shqiptare. Pra, PD-ja e ka "pickuar" shoqërinë. Dhe kjo është për t'u lavdëruar me zë të lartë. Në vijim, PD do të angazhohet gjithnjë e më shumë në mobilizimin shoqëror për të krijuar një aleancë mbipolitike për t'i bërë ballë Edi Ramës. Kjo është edhe përgjigja e pyetjes suaj. Në një terren ku vetëm për politikë të mirëfilltë nuk bëhet fjalë, përballja nuk mund të jetë thjesht politike. Duhet të jetë qytetare, duhet reagim mbarë shoqëror!

**Ju flisni për një aleancë**

**mbipolitike, por të ndalimi pak tek aleancat politike. LSI e ka bërë të qartë se do të jetë në koalicion zgjedhor me Partinë Demokratike, por sa do të ndihmojë ky bashkëpunim fitores e opozitës vitin e ardhshëm?**

Ndërsa PD ka bërë të qartë faktin se është ende shumë herët për të folur mbi aleancat dhe zgjedhjet! Pa u zgjidhur më parë çështja e krimit të organizuar qeveritar, e parave të pista dhe blerjes së votës, e pastrimit të politikës dhe vetingut të politikanëve, çdo diskutim për zgjedhjet në konceptin e normalitetit të tyre, të aleancave normale, të programeve normale etj., është thjeshtë i parakohshëm.

**Cili është konkretisht qëllimi i PD-së, shkurtimi i mandatit të qeverisjes së PS-së përmes zgjedhjeve të parakohshme, apo përgatitja e terrenit për fitoren e së djathtës në lokalit e 2019?**

Qëllimi i parë dhe thelbësor i Partisë Demokratike është dekriminalizimi i politikës, vetingu i politikës, asgjësimi i krimit të organizuar, pastrimi i politikanëve të lidhur me krimin. Po ra krimi, ka rënë Rama. Po ra krimi, ka fituar shoqëria shqiptare e me të gjithashtu, Partia Demokratike.

**A është e përgatitur PD-ja të qeverisë nëse shqiptaret, nëse vendi shkon në zgjedhje të parakohshme?**

Platforma e çlirimit të vendit nga krimi organizuar sapo ka filluar të shpalojë. Iniciativa të tjera ligjore do të ndërmerren. Përsa i përket platformës ekonomike, ju e kemi të qartë që Partia Demokratike e ka pasur gati ofertën e saj prej vitësh. Por kjo situatë nuk është normale. Kërkon çlirim nga krimi për t'u rikthyer në normalitet. E pastaj do kemi kohë të bindim shqiptarët se vetëm Partia Demokratike mund të zhvillojë vendin nga pikëpamja ekonomike dhe të zgjidhë problemet e rënda sociale të tij.

## Ish-ministri i Drejtësisë: Pushteti në zenit

### Manjani: Shteti në kolaps, si dilet nga gjendja e rëndë

**I**sh-ministri i Drejtësisë, Ylli Manjani shpreh shqetësimin se shteti është në kolaps, duke dhënë 5 propozime se si mund të dilet nga kjo gjendje. "Shteti është në kolaps. Pushteti në zenit. Politika thjesht prodhon llafe. Mendoj se fokusi është ndërtimi i shtetit. Çdo gjë që: 1. Shkëput strukturën e veting nga qeveria dhe faktorët të tjerë politikë. 2. Ndhimohet realisht në pastrimin e drejtësisë nga të paafët, hileqarët dhe të poshtrit. 3. Ndhimohet për të ngritur sa më parë Gjykatën e Lartë dhe Kustetuesen, me gjykatës të mirë dhe profesionistë. 4. Pavarëson nga qeveria dhe politika, prokurorinë dhe hetimin penal. 5. Ndhimohet për të ngritur sa më parë KLGJ, KLP dhe SPAK me emra e CV dinjitoze dhe jo me mbështetje politike. Pra, çdo gjë që ndihmon në hartimin e një kalendari të ri veprimesh për ndërtimin e sistemit të pavarur të drejtësisë, ka pasur dhe do ketë mbështetjen dhe kontributin tim modest!", deklaroi z.Manjani. Sipas tij, zgjidhje teknike ka plot. "Duhet thjesht vullnet për: 1. Ndërhyrë në Kushtetutë (në nenet tranzitore) 2. Rishikuar të gjitha ligjet e reja jo konsensuale. 3. Pastruar strukturat e reja nga emra politikë, vulnerabël ndaj politikës dhe të zgjedhur kundër ligjit. 4. Kthyer vetingu në shtratin e gjykimit sipas provave dhe ligjit e jo hamendjeve dhe gjykimit populor, aq më keq vendimmarrjes politike! Paralelisht duhet po i njëjti vullnet për të ndërtuar një sistem zgjedhor të ndershëm dhe përfaqësues. Ja, kaq duhet si për fillim! Të tjerat vijnë vetë...", shprehet ish-ministri i Drejtësisë.



imin për deputetët, zyrtarët e lartë të shtetit dhe largimin nga politika të të gjithë atyre që nuk justifikojnë pasuritë, apo kanë lidhje me krimin. "5 gjërat që duhet të dini për vetingun për politikën. Vetingu është

"Lëvizja e parë antikomuniste", Basha kujton kryengritjen e Postribës

**7**2 vite më parë, banorët e Postribës u ngritën kundër regjimit komunist të Enver Hoxhës. Nën udhëheqjen e Prek Calit, banorët e zonës së Kelmendit do t'u bënin qëndresë forcave komuniste që ishin nisur për të nënshtruar krahinën. Pasi i prenë në besë, forcat komuniste do të vrisnin dhjetëra banorë. "72 vjet nisi kryengritja e Postribës me Prek Calin dhe burrat kreshnikë të Shkodrës. Lëvizja e parë për liri në Europën komuniste u shtyp me gjak, por ajo i la kombit dëshminë e pavdekshme se për liri dhe të drejta ia vlen lufta me çdo çmim. Lavdi heronjve të Postribës!", shprehet kreu i PD-së, Lulzim Basha.

kanë që nuk justifikojnë pasurinë e tyre. Vetingu duhet të parashikohet në Kushtetutë dhe të miratohet nga 93 deputetë. Partia Demokratike ka depozituar draftin në Kuvend me 7 shtator", shprehet z.Basha.

Kryeministri grek, Aleksis Cipras, deklaroi dje se Greqia mbështet hapjen e negociatave të anëtarësimit për Shqipërinë, me kusht që Shqipëria të përbushë angazhimet e veta. Duke folur për negociatat mes dy shteteve, gjatë një konference për shtyp Cipras foli edhe për çështjen çame, duke u shprehur se një çështje e tillë nuk ekziston. Sipas kreut të ekzekutivit grek, Shqipëria duhet të rishikojë detin, varrezat dhe librat e historisë. "Negociatat po zhvillohen nga dy ministër dhe Jashtëm, janë çështje të vështira, por ndodhen në një nivel të mirë. Është e qartë se që të mbështesë Greqia hapjen e kapitujve për anëtarësimin e vendit fqinj,

## Kryeministri grek flet për negociatat me Shqipërinë

### Cipras: Disa po përpiqen ta fusin nga "dritarja" çështjen çame

#### DEKLARATA

Cipras foli edhe për çështjen çame, duke thënë se ajo nuk ekziston. "Gjithashtu, disa përpiqen të fusin nga 'dritarja' çështjen çame. Nuk ekziston kjo çështje", - theksoi kryeministri grek.

duhet që Shqipëria të përbushë një sërë angazhimesh. Shumë nga këto angazhime ekzistojnë prej kohësh, që nga viti 2009. E kam fjalën për zonat detare, ndry-

shimin e teksteve shkollore, varrezat e ushtarëve grekë në Shqipëri. Dhe sigurisht, një çështje shumë e rëndësishme e reformave janë ato në lidhje me të drejtat e mi-

noritetit grek", theksoi z.Tsipras. Sipas tij, çështja çame nuk ekziston, teksa kritikoi edhe zërat grekë se bisedimet për mirëmbajtjen e piramidave në kufi i kanë interpretuar si ripërcaktim të kufijve ndërmjet të dy vendeve. "Janë dëgjuar shumë për këto negociata. Shumë nga çka janë thënë nuk kanë lidhje me realitetin. Brenda kuadrit të bisedimeve është edhe mirëm-



bajtja e piramidave, që shënojnë kufijtë me vendin fqinj dhe disa thanë se po shkojmë të bëjmë një ripërcaktim kufijsh. Gjithashtu, disa insistojnë të fusin nga dritarja çështjen çame. Nuk ekziston një çështje e tillë

dhe sigurisht do të thosha që në këto çështje do të ishte mirë të kishte më shumë konsensus, sepse në çështje të ketë informim, mirëkuptim dhe besim", tha kryeministri grek.

Dy presidentët takohen në Durrës: Forcimi i stabilitetit rajonal dhe perspektivës europiane

# Meta-Thaçi: Dialogu me Serbinë garanton njohjen reciproke

"I shërben së ardhmes në BE të të dyja vendeve"

Valentina Madani

Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta në kulmin e debateve për kufijtë takoi dje në Durrës homologun kosovar, Hashim Thaçi duke vënë theksin te vijimi i dialogut me Serbinë. Në qendër të diskutimeve mes tyre në drekën e punës të zhvilluar në Durrës ishte forcimi i stabilitetit rajonal dhe perspektivës europiane të rajonit është qëllim i përbashkët. Në takim mësohet se është diskutuar edhe dialogu Kosovë-Serbi, për të cilin Meta është shprehur se vazhdimi i tij do të garantojë njohje reciproke midis dy vendeve, si dhe do të garantojë të ardhmen e tyre në BE. Meta nënvizoi se është me rëndësi vazhdimi i dialogut për normalizimin përfundimtar të marrëdhënieve Kosovë-Serbi që do të garantojë jo vetëm njohje reciproke midis dy vendeve si edhe të ardhmen e tyre në BE, por edhe një bashkëjetesë të përhershme midis shqiptarëve e serbëve në interes të gjeneratave të ardhshme. Në takim mes tyre, dy presidentët kanë theksuar se rritja e mëtejshme e shkëmbimeve të gjithanshme midis Shqipërisë dhe Kosovës është një prioritet i përbashkët. "Kënaqësi të takohesha sot (dje) në Durrës për një drekë pune me Presidentin e Republikës së Kosovës, z.Hashim Thaçi. Rritja e mëtejshme e shkëmbimeve të gjithanshme midis dy vendeve është një prioritet i përbashkët. Forcimi i stabilitetit rajonal dhe perspektivës europiane të rajonit është qëllim i përbashkët. Ndaj është me rëndësi vazhdimi i dialogut për normalizimin përfundimtar të marrëdhënieve Kosovë-Serbi, që do të garantojë jo vetëm njohje reciproke midis dy vendeve si edhe të ardhmen e tyre në BE, por edhe një bashkëjetesë të përhershme midis sh-



Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta me homologun kosovar, Hashim Thaçi, dje në Durrës

qiptarëve e serbëve në interes të gjeneratave të ardhshme", shprehet kreu i shtetit, Ilir Meta. Dy ditë më parë, Meta pati një takim dhe me kreun e Vetëvendosjes, Albin Kurti. Vetë Presidenti Meta publikoi një foto nga takimi

në rrjetin social "Facebook", teksa shkruan: "Kënaqësi të takohesha sot me liderin e Vetëvendosjes, z.Albin Kurti në Karpen". Në fokus të takimit mendohet të ketë qenë vizita e Vuçiq në Kosovë. Albin Kurti është takuar

edhe me kreun e PD, Lulzim Basha. Gjatë së premtës mbrëma, Kurti takoi ish-kryeministrin Sali Berishën, i cili e ka akuzuar Hashim Thaçin se është bërë vegël e Beogradit në temën e ndryshimit të kufijve.

## "Viti i Skënderbeut", Rama ftesë artistëve: Bëhuni pjesë e konkursit të krijimtarisë muzikore

Kryeministri Edi Rama e nisi ditën e djeshme me një ftesë për artistët për qenë pjesë e Konkursit Mbarëkombëtar të Krijimtarisë Muzikore në gjinitë opera, balet dhe muzikal. Aktiviteti mbahet në kuadër të "Vitet të Skënderbeut". Kreu i qeverisë sqaron se më 11 tetor përfundon faza e parë që parashikon aplikimin e kandidatëve, të cilët janë të mirëpritur në këtë sfidë të bukur kulturore. "Mirënjohjesi dhe me këtë ftesë për të qenë pjesë me artin tuaj në Konkursin Mbarëkombëtar të Krijimtarisë Muzikore në gjinitë opera, balet dhe muzikal, ju uroj një të diel të bukur. Pa imponuar tematikë, Viti i Skënderbeut është një kornizë e mirë për të nxitur krijimtari kombëtare artistike të cilat, me të drejtë, nuk mund të arrihen pa një mbështetje thelbësore në financim, por edhe kanë nevojë për instrumente realizues të vënies në skenë. Për këtë, Ministria e Kulturës krijoi një fond të dedikuar dhe kritere shumë të qarta për pjesëmarrje, por edhe Teatri i Operas dhe Baletit vendos në dispozicion të fituesve trupat realizuese dhe hap repertorin për vënien në skenë të veprave që do të dallin nga ky konkurs, e që do të përzgjidhen nga juri profesioniste ndërkombëtare. Në muajin tetor (11 tetor) përfundon faza e parë që parashikon aplikimin e kandidatëve, të cilët janë të mirëpritur në këtë sfidë të bukur kulturore. Krijimtari të mbarë dhe ju mirëpresim", shprehet z.Rama.



#### DENONCIMI

Deputetja e PD-së, Lindita Metaliaj denoncoi dje braktisjen e banorëve në Lezhë, mungesën totale të investimeve në zonën e Torovicës. Banorët e fshatit Torovicë të Lezhës shprehen të induar për mungesën e theksuar të investimeve në infrastrukturë, subvencioneve të fermerëve dhe largimit masiv të banorëve nga Shqipëria, veçanërisht fuqisë punëtoare.

## VITI I RI SHKOLLOR



### Bushati shpërndan libra falas te familjet në nevojë

Në prag të nisjes së viti të ri shkollor, ministrat e kabinetit "Rama" janë angazhuar për të ndjekur nga afër procesin e shpërndarjes së teksteve falas për ciklin fillor dhe për të garantuar familjet në nevojë për mbështetje. Ministri i Jashtëm, Ditmir Bushati që është drejtuesi politik i zonës së Malësisë së Madhe në qarkun Shkodër shpërndau librat falas për pesë fëmijë të dy familjet në nevojë në këtë zonë. "Familjet me mungesë të ardhurash me e rimbursu këtë punë. Vitin tjetër dona me e zgjeru sa më shumë aq sa kena mundësi me bo se edukimi është shumë i rëndësishëm", tha z.Bushati.



Arrestimi, 31-vjeçari Elvis Gjata u denoncua nga personat e mashtruar

KORÇË

Gjykata e Korçës ka vendosur masën e sigurisë arrest me burg për juristin e Hipotekës së Korçës. Mbi Elvis Gjateë rëndon akuzat e mashtrimit të kryer në bashkëpunim, pasi dyshohet se Gjata ka mashtruar disa persona nga Librazhdi. Nga sa bëhet e ditur, i riu u kishte marrë një shumë parash dhe u kishte premtuar se do ndërhynte që çështjen e tyre gjyqësore. Pas disa rasteve ka ardhur edhe denoncimi për mashtrim ndaj tij, ku edhe është vënë në pranga. Sipas organit të akuzës, juristi i mori nëpërmjet mashtrimit 8 mijë euro një gruaje nga Librazhdi. Arrestimi i tij u bë gjatë mbrëmjes së të enjtes nga policia e Korçës. 31-vjeçari u denoncua nga personat e mashtruar dhe pas hetimit, prokuroria e Korçës lëshoi urdhrin e arrestit. Ndërkaq, bëhet e ditur se ky rast nuk lidhet me detyrën e Elvis Gjatës si jurist pranë ZVRPP-Korçë, pasi ky proces gjyqësor lidhet me një problem tjetër.

**ARRESTIMI**

Policia e Korçës ka arrestuar mbrëmjes së të enjtes juristin e hipotekës në këtë qytet, pasi në maj të këtij viti ka përvehtësuar një shumë parash prej 8 mijë eurosh. Specialistët e Seksionit kundër Krimin Ekonomik-Financiar, në Drejtorinë Vendore të Policisë Korçë bënë ndalimin e shtetasit Elvis Gjata, 31 vjeç, banues në

# Përfitoi 8 mijë euro, lihet në burg juristi i Hipotekës së Korçës

*Prokuroria: Përvetësoi një shumë parash për të zgjidhur një çështje gjyqësore*



31-vjeçari Elvis Gjata

Korçë. Gjithashtu, filloi procedimi penal dhe u bë shpallë në kërkim shtetasit E.F., 32 vjeç dhe K.G., 30 vjeç, të dy banues në Korçë. "Këta shtetas në bash-

këpunim me tyre, nëpërmjet mashtrimit, dyshohet se në muajin maj të vitit 2018 i kanë përvehtësuar shumën prej 8000 eurosh, me qëllim zgjidhjen e një problemi

gjyqësor, shtetas D.H. 36 vjeç, banues në Librazhd. Materialet për veprime të mëtejshme i kaluan Prokurorisë të Rrethit Gjyqësor Korçë bazuar në

MASHTRIMI	DENONCIMI
Sipas organit të akuzës, juristi Elvis Gjata nëpërmjet mashtrimit, në bashkëpunim me shtetas të tjerë dyshohet se në muajin maj të vitit 2018 kanë përvehtësuar shumën prej 8000 eurosh me qëllim zgjidhjen e një problemi gjyqësor.	Gjata u denoncua nga personat e mashtruar dhe pas hetimit, prokuroria e Korçës lëshoi urdhrin e arrestit. Ndërkaq, bëhet e ditur se ky rast nuk lidhet me detyrën e Elvis Gjatës si jurist pranë ZVRPP-Korçë.

nenin 143/2 të Kodit Penal", thuhej në njoftimin e policisë. Ndërkohë, më herët Hipoteka e Korçës reagoi dhe bëri me dije se nuk ka lidhje arrestimi me punën e tij

pranë hipotekës. "Ky rast gjyqësor nuk lidhet me detyrën e Elvis Gjatës si jurist pranë ZVRPP-Korçë, por me një problem tjetër", thuhej në reagimin e hipotekës.


## Një makinë tip "Hyundai" përplas me "Benz"-in Aksident i rëndë në aksin Poshnje-Ura Vajgurore, 5 të plagosur

**BERAT** - Një aksident i rëndë ka ndodhur në orët e para të mëngjesit të djeshëm në aksin Poshnje-Ura Vajgurore. Një makinë tip "Hyundai" me targa greke është përplasur me një mjet tip "Benz". Mësohet se mjeti tip "Benz" drejtohej nga Bujar Tallas, ndërsa mjeti me targa greke drejtohej nga Jani Papa, që udhëtonte bashkë me gruan dhe 2 fëmijët. Si pasojë e aksidentit, dy drejtuesit e mjeteve dhe tre pasagjerët që ndodheshin në makinën me targa greke mbetën të lënduar, por jashtë rrezikut për jetën. Në gjendje më të rëndë është Jani Papa, i cili u transportua në Spitalin e Traumës Tiranë. "Në aksin rrugor Poshnje-Ura Vajgurore, tek ish-SMT, një mjet tip 'Hyundai' me targa greke me drejtues shtetasin J.P. 37 vjeç është përplasur me një mjet tip 'Benz' me drejtues shtetasin B.T. 53 vjeç. Për pasojë u dëmtuan shtetas J.P. dhe tre pasagjerët në mjetin e tij si dhe drejtuesi i mjetit tip 'Benz', të cilët u transportuan në Spitalin Rajonal Berat.



**AKSIDENTI**  
Si pasojë e aksidentit, dy drejtuesit e mjeteve dhe tre pasagjerët që ndodheshin në makinën me targa greke mbetën të lënduar, por jashtë rrezikut për jetën. Në gjendje më të rëndë është Jani Papa, i cili u transportua në Spitalin e Traumës në Tiranë.

**STRATI** Shoqëria përbarimore "STRATI BAILIFFS SERVICE" Sh.p.k., njofton shpalljen për shlyerje në ankand të pasurive të paluajtshme:  
- "Apartamenti", me Nr. 11/33+1-23 pasurisë, me sipërfaqe 73 m<sup>2</sup>, Zona Kadastrale 8603, volumni 36, faqe 92, regjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë në pronësi të Shoqërisë "Evi Konstruksion" Sh.p.k. Çmimi fillestar i ankandit është 20.440 Euro.  
- "Apartamenti", me Nr. 11/33+1-23 pasurisë, me sipërfaqe 73 m<sup>2</sup>, Zona Kadastrale 8603, volumni 36, faqe 92, regjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë në pronësi të Shoqërisë "Evi Konstruksion" Sh.p.k. Çmimi fillestar i ankandit është 20.440 Euro.  
- "Njësi", me Nr. 11/33-111 pasurisë, me sipërfaqe 26 m<sup>2</sup>, Zona Kadastrale 8603, volumni 36, faqe 62, regjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë në pronësi të Shoqërisë "Evi Konstruksion" Sh.p.k. Çmimi fillestar i ankandit është 11.560 Euro.  
Ankandi për pasuritë e mësipërme zhvillohet në datë 13.09.2018.  
Ankandi për pasuritë e mësipërme zhvillohet në ora 16.00 në ambientin e Shoqërisë Përbarimore "Strati Bailiff's Service", Rruga "Jordan Misir", Pall. 14111, Shkalla 1, Ap. 7, Tiranë. Tel: 04 45 00 450, www.stratibailiff.com, info@stratibailiff.com



## Furgoni i Policisë Kufitare përplas motorin, plagoset 69-vjeçari

**SHKODËR** - Një aksident rrugor ka ndodhur ditën e djeshme në vendin e quajtur 'Shtëpitë e malësorëve', në fshatin Oblikë. Bëhet me dije se një motor pa targa, i drejtuar nga shtetas H. B. 69 vjeç, është përplasur me mjetin tip furgon të Policisë Kufitare Shkodër, me drejtues punonjës në policisë F.K., 49 vjeç. Si pasojë e përplasjes ka mbetur i dëmtuar 69-vjeçari, drejtues i motorçikletës, i cili u dërgua për ndihmë mjekësore në Spitalin Rajonal Shkodër dhe aktualisht ndodhet nën kujdesin e mjekëve. Në vendngjarje ka shkuar një grup hetimor për zbardhjen e plotë të rrethanave të aksidentit. "Më datë 09.09.2018, ora 08:00, një mjet i jofuqar se në vendin e quajtur 'Shtëpitë e malësorëve', fshati Oblikë, Shkodër, ka ndodhur një aksident rrugor, ku është përplasur një motor pa targa, i drejtuar nga shtetas H. B. 69 vjeç, banues në lagjen Liria, Shkodër me mjetin tip furgon i Policisë Kufitare Shkodër me targë SH0238E, me drejtues punonjës në policisë F. K. 49 vjeç, banues në Shirokë, Shkodër. Si pasojë e përplasjes ka mbetur i dëmtuar drejtuesi i motorçikletës, i cili u dërgua për ndihmë mjekësore në Spitalin Rajonal Shkodër nën kujdesin e mjekëve. Në vendngjarje po kryen veprimet grupi hetimor nën drejtimin e Prokurorisë Rrethit Gjyqësor Shkodër për sqarimin e rrethanave të aksidentit", thuhet në njoftimin e policisë.

## PENSIONET E PLEQËRISË KONTRIBUTET DHE LLOGARITJA

Drejtesja e INAS: Ja sa kohë mund të zgjatë procedura. Formulari i periudhave të sigurimit

# Pensionet e pleqërisë, verifikimi i saktë i viteve të punës

Beskida Aliaj: Kushtet e përfitimit dhe dokumentacioni

Voltiza Duro

J o në pak raste të moshuarit para se të aplikojnë për pension pleqërie, kanë shumë paqartësi mbi mënyrën e verifikimit të kontributeve, çka lidhet drejtpërdrejt me masën e pagesës që do të marrin. Por tashmë të gjithë ata që kanë mbushur moshën për të përfituar pension, mund të drejtohen pranë patronatit "INAS Albania" për të shqyrtuar nga afër dokumentacionin dhe periudhën për të cilën ata kanë punuar me siguri. Drejtesja e këtij patronati, Beskida Aliaj tregon për "Gazeta Shqiptare" se në bashkëpunim me Institutin e Sigurimeve Shoqërore janë në gjendje të verifikojnë në arkivën e këtij institucioni të gjitha periudhat e punës dhe kontributeve të derdhura. Ajo gjithashtu thekson edhe kushtet që duhet të përmbushin kandidatët e dokumentacionin që duhet të dorëzojnë për të përfituar nga ky pension. Drejtesja e INAS bën me dije se verifikimi i periudhave kontribute kryhet nga ky patronat edhe për shqiptarët që kanë punuar e jetuar në Itali. "Përsa i përket shqetësimit për mungesën e librezës së punës, në këtë aspekt një ndihmë të rëndësishme e ofron patronati INAS. Çdokush mund t'i drejtohet patronatit për të pasur konfirmim për periudhat e punës e të kontributeve të derdhura në të gjitha institucionet dhe ndërmarrjet ku ka punuar. Bazuar në marrëveshjen që INAS ka lidhur me Institutin e Sigurimeve Shoqërore në Shqipëri, ISSH, patronati është në gjendje të verifikojë të gjitha periudhat kontribute në arkivën e këtij institucioni", - thekson Aliaj për të gjithë të interesuarit.

### VERIFIKIMI

Verifikimi i periudhave kontribute kryhet nga ky patronat edhe për shqiptarët që kanë punuar e jetuar në Itali. "Përsa i përket shqetësimit për mungesën e librezës së punës, në këtë aspekt një ndihmë të rëndësishme e ofron patronati INAS. Çdokush mund t'i drejtohet patronatit për të pasur konfirmim për periudhat e punës e të kontributeve të derdhura në të gjitha institucionet dhe ndërmarrjet ku ka punuar. Bazuar në marrëveshjen që INAS ka lidhur me Institutin e Sigurimeve Shoqërore në Shqipëri, ISSH, patronati është në gjendje të verifikojë të gjitha periudhat kontribute në arkivën e këtij institucioni", - thekson Aliaj për të gjithë të interesuarit.

### APLIKIMI


Në formularin 'Periudha Sigurimi', kandidati që do të aplikojë për pension duhet të shënojë në rend kronologjik të gjitha të dhënat mbi periudhat kontribute. Këto të dhëna përfshijnë: ndërmarrjen, institucionin, ish-kooperativën apo subjektin ku ka punuar individ. Gjithashtu, duhet të specifikojë detajet që ka kryer, datën e fillimit dhe të largimit nga ai vend pune si dhe vërejtjet. "Për aplikimin për pension, sipas mundësisë që kandidatët kanë, ose mund të paraqiten vetë, ose të prokurorin një të afërmin e tyre. Të gjitha procedurat mund t'i kryejnë edhe me ndihmën e drejtpërdrejtë të INAS-it, pa asnjë pagesë", - bën me dije ekspertja.

tributive në arkivën e këtij institucioni", - thekson Aliaj për të gjithë të interesuarit. Ndërkohë, duke qenë se arkivi i vjetërsisë së punës është në proces informatizimi, procedurat për marrjen e një përgjigjeje mund të zgjasin deri në një muaj. Në rastet kur i interesuari i di me saktësi periudhat e punës e të kontributeve të derdhura, në çastin e aplikimit për pension, përpilon formularin 'Periudha Sigurimi'. Në formularin 'Periudha Sigurimi', kandidati që do të aplikojë për pension duhet të shënojë në rend kronologjik të gjitha të dhënat

mbi periudhat kontribute. Këto të dhëna përfshijnë: ndërmarrjen, institucionin, ish-kooperativën apo subjektin ku ka punuar individ. Gjithashtu, duhet të specifikojë detajet që ka kryer, datën e fillimit dhe të largimit nga ai vend pune si dhe vërejtjet. "Për aplikimin për pension, sipas mundësisë që kandidatët kanë, ose mund të paraqiten vetë, ose të prokurorin një të afërmin e tyre. Të gjitha procedurat mund t'i kryejnë edhe me ndihmën e drejtpërdrejtë të INAS-it, pa asnjë pagesë", - bën me

### KUSHTET E PËRFITIMIT

Personat që kanë periudha sigurimi, kanë të drejtën e përfitimit të pensionit të pjesshëm pleqërisë kur: plotësojnë moshën 65 vjeç për burrat dhe 60 vjeç e 6 muaj plus me koeficientin e rritjes së jetëgjatësisë për gratë; kanë jo më pak se 15 vjet periudha sigurimi dhe jo më shumë se 35 vjet periudha sigurimi; janë tërhequr nga veprimtaria ekonomike. Nëse një person ka punuar 21 vite me kontribute në Shqipëri e mbush moshën 60 vjeç e 6



### KUSHTET E PËRFITIMIT

- ◆ Plotësojnë moshën 65 vjeç për burrat dhe 60 vjeç e 6 muaj plus me koeficientin e rritjes së jetëgjatësisë për gratë.
- ◆ Të kenë jo më pak se 15 vjet periudha sigurimi dhe jo më shumë se 35 vjet periudha sigurimi.
- ◆ Të jenë tërhequr nga veprimtaria ekonomike.

### DOKUMENTACIONI

- ◆ Fotokopje e kartës së identitetit.
- ◆ Certifikatë e gjendjes familjare.
- ◆ Certifikatë martesë për gratë (për efekt të mbiemrit të kohës së vajzërisë, me të cilin mund të ketë periudha pune).
- ◆ Dy fotografi.
- ◆ Libreza e punës (në mungesë të saj plotësimi i rubrikave të punës).
- ◆ Vërtetim i Degës Ushtarake për periudhën e kryerjes së shërbimit të detyrueshëm ushtarak (për kërkuesit meshkuj).
- ◆ Diploma e shkollës së lartë për gratë (e cila konsiderohet vjetërsi pune).
- ◆ Çdo dokument tjetër justifikues, që vërteton qenien në punë.
- ◆ Vërtetim page, sipas së cilës është derdhur kontribut për periudhat e sigurimit që nga 01.01.1994 deri në momentin e shkëputjes nga puna, sipas formularit tip (nëse ka punuar dhe ka derdhur kontribute për periudhat pas datës 01.01.1994).
- ◆ Çdo dokument tjetër justifikues, që vërteton pagën ose derdhjen e periudhave kontribute.
- ◆ Fotokopje e librezës së pagimit të energjisë elektrike.

muaj, atëherë do të përfitojë pension të pjesshëm pleqërie, që është i barabartë në përqindje me raportin 21 vite që ka punuar, me 35 vite që nevojiten për pension të plotë pleqërie, pra përfituesi do të marrë 60% të pensionit të plotë.

### DOKUMENTACIONI

Dokumentacioni që duhet të duhet të paraqesin të moshuarit përfshin: fotokopjen e kartës së identitetit, certifikatën e

gjendjes familjare, certifikatë martesë për gratë (për efekt të mbiemrit të kohës së vajzërisë, me të cilin mund të ketë periudha pune), dy fotografi, libreza e punës e në mungesë të saj plotësimi i rubrikave të punës, vërtetim i Degës Ushtarake për periudhën e kryerjes së shërbimit të detyrueshëm ushtarak (për kërkuesit meshkuj), diploma e shkollës së lartë për gratë, e cila konsiderohet vjetërsi





Drejtuësja e patronatit "INAS Albania": Ja shembujt konkretë, bazuar në koeficientet e indeksimit

# Ekspertja: Si të llogarisni pensionet, formula e saktë

Pagat e indeksuara nga viti 1994 deri në 2015-ën

Voltiza Duro

Personat që kanë periudha sigurimi, kanë të drejtën e përfitimit të pensionit të pjesshëm të pleqërisë kur: plotësojnë moshën 65 vjeç për burrat dhe 60 vjeç e 6 muaj plus me koeficientin e rritjes së jetëgjatësisë për gratë; kanë jo më pak se 15 vjet periudha sigurimi dhe jo më shumë se 35 vjet periudha sigurimi dhe janë tërhequr nga veprimtaria ekonomike.

## VERIFIKIMI I PERIUDDHAVE KONTRIBUTIVE NË ITALI

Patronati është në gjendje të verifikojë të gjitha periudhat kontributive, në arkivën e institucionit Istituto Nazionale Previdenza Sociale e thënë ndryshe INPS ose institucion ky analog me Institutin e Sigurimeve Shoqërore në Shqipëri. Duke qenë se në Itali ky shërbim ofrohet i informatizuar, ne mund të futemi 'online' në sistemin INPS meqë kemi akses dhe fjalëkalimet e ofruara nga vetë institucioni dhe i nxjerrim këto periudha të punës në Itali, për qytetarin shqiptar, për jo më shumë se 5 minuta dhe mjafton që qytetari të ketë me vete një kartë identiteti dhe një kod fiskal. Ekstrati i periudhave kontributive është dokumenti që rendit të gjitha kontributet e bëra në INPS në favor të punëtorit. Ai përmbledh pagesat e punës, figurative dhe reduktuese, të ndara sipas ndërmarrjeve ku punonjësi është i regjistruar. Me ekstratin e periudhave kontributive, punonjësit mund të kontrollojnë rregullsinë e kontributiveve të paguara nga ata vetë ose punëdhënësit e tyre për të sinjalizuar edhe ndonjë diskordance me INPS. Deklarata e pensionit detajon të dhënat personale të punonjësit dhe përmbledhur në një tabelë, përfitimet e sigurimeve shoqërore të ndara në: periudhën e referencës; llojin e kontributiveve pra të punësuar, zejtar, tregti, shërbim ushtarak; shpërblim ose të ardhura, referencat e punëdhënësit si dhe kontributet e dobishme të shprehura në ditë, javë ose muaj, si për llogaritjen e pensionit ashtu edhe për arrijtjen e të drejtës.

← pune. Gjithashtu aplikuesit i nevojitet çdo dokument tjetër justifikues, që vërteton qenien në punë; vërtetimin page, sipas së cilës është derdhur kontribut për periudhat e sigurimit që nga 01.01.1994 deri në momentin e shkëputjes nga puna, sipas formularit tip nëse ka punuar dhe ka derdhur kontribut për periudhat pas datës 01.01.1994. Ndërkaq, aplikuesi duhet të dorëzojë edhe çdo dokument tjetër justifikues, që vërteton pagën ose derdhjen e periudhave kontributive si dhe një fotokopje të librezës së pagimit të energjisë elektrike.

Baza për llogaritjen e pensionit nuk është më pensioni bazë (pension minimal), por pensioni social. Drejtoresha e patronatit "INAS Albania", njëkohësisht eksperte pensionesh, Beskida Aliaj tregon për "Gazeta Shqiptare" mënyrën sesi qytetarët mund të përllogarisin saktë pensionin që u takon në bazë të viteve të punës dhe pagës. Ajo më tej shton se sipas ligjit, iu lind e drejta e përfitimit të pensionit të gjithë individëve të siguruar që kanë plotësuar jo më pak se 15 vite sigurim shoqëror, në momentin kur arrijnë moshën e paracaktuar. "Personat e siguruar që kanë plotësuar jo më pak se 15 vite sigurim shoqëror kanë të drejtë për pension pleqërie, kur të arrijnë moshën e paracaktuar në nënin 92 të këtij ligji", - theksohet në ligjin "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", përsa i përket pensionit të pleqërisë në vendin tonë. Ndërkohë, personat e siguruar kanë të drejtë për pension pleqërie të reduktuar, deri tre vjet para mbushjes së moshës së daljes në pension të paracaktuar në nënin 92 kur kanë plotësuar vitet e sigurimit sipas nenit 92; apo nuk kryejnë veprimtari ekonomike si të punësuar, punëdhënësit ose të vetëpunësuar. Ndërkaq, nënat që kanë lindur 6 a më shumë fëmijë, të cilët janë të rritur më shumë se 8 vjeç, kanë të drejtë të dalin në pension kur mbushin moshën 55 vjeç dhe kanë 30 vjet sigurim.

"Për të lindur e drejta për pension pleqërie, kërkohen dy kushte, që janë vjetërsia kontributive jo më pak se 15 vite kontributive dhe moshja, që përcaktohet sipas tabelës së paraqitur në nënin 43 të ligjit (që ndryshon nënin 92). Aktualisht për vitin 2018 moshja e daljes në pension sipas nenit 43, për gratë është 60 vite e 8 muaj pasi rritet për çdo vit me 2 muaj deri në vitin 2056 që arrijnë në 67 vjeç. Ndërsa për burrat 65 vjeç (mosha fillon rritet që nga viti 2033 me nga 1 muaj në vit për të arritur në 67 vjeç në vitin 2056)", - thotë ekspertja për "GSH". Ndërkaq, ajo shton se vjetërsia e plotë kontribu-



tive për të dyja gjinitë është 35 vite e 8 muaj, e cila rritet me 4 muaj në vit për të arritur me 40 vite në vitin 2029.

**PËRLLOGARITJA**  
Për llogaritjen e pensionit të pleqërisë sipas ligjit 104/2014, neni 18 i cili ndryshon nënin 32 të ligjit 7703 datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë" përcaktohet si më poshtë: Pensioni mujor i pleqërisë përbëhet nga një shumë bazë dhe nga një shtesë. Ndërkohë, shuma bazë llogaritet si raport i periudhës së sigurimit që ka realizuar personi me periudhën e sigurimit të kërkuar sipas nenit 92, shumëzuar me pensionin social. "Ndërsa shtesa do të jetë 1 për qind për vit sigurimi shumëzuar me bazën mesatare të vlerësuar që personat e siguruar kanë arritur nëpërmjet kontributiveve, e llogaritur sipas nenit 31 të ligjit 104/2014 ( i cili ndryshon nënin 59 të ligjit 7703 datë 11.05.1993 ). Shuma e përgjithshme e pensionit nuk mund të jetë më e vogël se pensioni social", - thekson Aliaj për "GSH". Kjo e fundit bën me dije për të gjithë të interesuarit se për ta pasur sa më të qartë këtë përllogaritje, është e nevojshme të dihet se çfarë përfaqëson pensioni social. Ndërkohë, sipas ligjit 104/2014, pensioni social është një përfitim që i jepet çdo shtetasi shqiptar, i cili ka mbushur moshën 70 vjeç, është me qëndrim të përhershëm në Shqipëri të paktën për pesë vitet e fun-

"Personat e siguruar që kanë plotësuar jo më pak se 15 vite sigurim shoqëror kanë të drejtë për pension pleqërie, kur të arrijnë moshën e paracaktuar në nënin 92 të këtij ligji", - theksohet në ligjin "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", përsa i përket pensionit të pleqërisë në vendin tonë.

dit, nuk plotëson kushtet për asnjë lloj pensioni nga skema e detyrueshme e sigurimeve shoqërore dhe nuk ka të ardhura, ose të ardhurat që përfiton nga çdo burim tjetër, janë më të ulëta se të ardhurat që jep pensioni social. Masa e këtij pensioni social është e barabartë me të ardhurat minimale që sigurohen nga pensioni i pjesshëm i pleqërisë me 15 vite të siguruar me pagë minimale, i llogaritur në datën 31.12.2014. Ndërsa masa e pensionit social për personat që kanë të ardhura nga burime të tjera, do të jetë sa diferenca e pensionit social

me të ardhurat e tjera që ka përfituesi. Kriteret, procedurat dhe dokumentacioni për pensionin social përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave. Për llogaritjen e pensionit përdoret formula: PP (Pension i pleqërisë) = PS (Pension Social) \* (shumëzuar) vjetërsi kontributive të realizuara / vjetërsi kontributive që kërkohet +1/100\* (shumëzuar) vite sigurimi\* (shumëzuar) BV ( baza e vlerësuar).

## BAZA E VLERËSUAR

Baza e vlerësuar për llogaritjen e pensioneve llogaritet si raport i shumës së pagave, për të cilat janë paguar kontributet, me periudhën që njihet si periudhë sigurimi. "Për periudhën e sigurimit nga data 1.1.1994 e në vazhdim, për llogaritjen e bazës së vlerësuar, merret shuma e pagave, për të cilat janë paguar kontributet nga data 1.1.1994 deri në fund të periudhës së sigurimit. Për periudhën e sigurimit në institucione dhe ndërmarrje shtetërore para datës 1.1.1994, për llogaritjen e bazës së vlerësuar, merren pagat referuese, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave. Për periudhën e sigurimit në ish-kooperativat bujqësore, për llogaritjen e bazës së vlerësuar, merren pagat referuese të caktuara me Vendim të Këshillit të Ministrave", - bën me dije Aliaj.

Operacionet antidrogë, sekuestrohen rreth 8 tonë marijuanë për 10 muaj

# Kapen 20 kg marijuanë në kufirin grek, arrestohet 52-vjeçari shqiptar

Lënda narkotike u gjet në një mjet, e ndarë në dy qese të zeza

GREQI

Policia greke ka zhvilluar një operacion në kufirin greko-shqiptar, ku janë sekuestruar 20 kg marijuanë. Në kuadër të këtij operacioni u arrestua një 52-vjeçar shqiptar, identiteti i të cilit nuk është bërë ende i ditur. Lënda narkotike u gjet në një mjet, i cili po drejtohej nga një shtetas shqiptar. Gjatë kontrollit të ushtruar nga policia greke brenda mjetit u gjetën dhe u sekuestruan dy qese të zeza që përmbanin 20 kg 850 gramë marijuanë. Gjithashtu, në makinë u gjetën dhe sekuestruan 2 celularë me 2 karta SIM, 250 euro dhe 8600 lekë të reja shqiptare. Sipas policisë greke, prej fillimit të vitit e deri sot në Igumenicë, Korfuz, Lefkadha, Kefalonia, Janinë, Athinë, Selanik, Artë, Aitiloakarnania, Kostur, Grevena, Follorine, Aleksandroupoli etj. janë sekuestruar në total rreth 8 ton marijuanë, e cila vinte nga Shqipëria.

## OPERACIONE ANTIDROGË

Disa ditë më parë në kuadër të një operacioni të zhvilluar nga policia greke, tre shqiptarë janë kapur në Selanik me rreth 50 kilo-



Droga e sekuestruar në Greqi

gramë marijuanë. Shqiptarët, identiteti i të cilëve nuk u bë i ditur, u kapën teksa ngarkonin automjetin e tyre me 42 pako, që përmbanin 43 kg 535 gramë marijuanë. Gjithashtu në banesën e tyre u gjetën dhe sekuestruan edhe 6 kg 631

gramë marijuanë si dhe 49.7 gramë kokainë. U bë me dije se tre shqiptarët e arrestuar janë të moshës 33, 45 dhe 52 vjeç. Ndërkohë, rreth një javë më parë policia greke ka zhvilluar dy operacione në kufirin greko-shqiptar, ku ka sekuestruar një sasi prej



Makina ku u gjet droga

192 kg marijuanë. Në operacionin e parë, i cili u zhvillua në Nerajdhja, Igumenicë, u ndalua një automjet brenda të cilit u gjetën dhe sekuestruan 99 pako me 106 kg 740 gramë marijuanë. Në kuadër të këtij operacioni u arrestuan dy shtetas grekë,

një burrë 47 vjeç dhe një grua 46 vjeçe. Ndërkohë në operacionin e dytë në Menidhi, Aitiloakarnania, u arrestua një çift shqiptar, përkatësisht 21 dhe 20 vjeç, pasi në mjetin e tyre u gjetën dhe sekuestruan 85 pako me 85 kg 915 gramë marijuanë.

8

## TONË

Prej fillimit të vitit e deri sot, në Igumenicë, Korfuz, Lefkadha, Kefalonia, Janinë, Athinë, Selanik, Artë, Aitiloakarnania, Kostur, Grevena, Follorine, Aleksandroupoli etj. janë sekuestruar në total rreth 8 tonë marijuanë, e cila vinte nga Shqipëria.



## INVITATION TO TENDER

### REHABILITATION OF THE TWO PRIMARY HEALTH CENTRES IN VORA AND SAUK

The Health for All Project (HAP) in Albania is funded by Swiss Agency for Development and Cooperation (SDC) of the Swiss Government and is being implemented by a consortium of three organizations: the Swiss Tropical and Public Health Institute (Swiss TPH), and the two NGOs: Terre des hommes (TdH) and Save the Children (SC) through HAP Center. Its overall objective is that the Albanian population, benefit from better health due to improved primary health care services and health promotion activities.

HAP will rehabilitate two primary health care centers; one health center in Vora, in the municipality of Vora and the second health center in Sauk, in the municipality of Tirana. In the context of this initiative, HAP Centre is requesting offers from companies interested to carry out those rehabilitation works.

The required documents, forms, technical specifications and annexes for the bidding can be found in the HAP web site link: <http://www.hap.org.al/opportunities-for-cooperation-2/>

The interested Companies should express their interest in participating in this tender by sending an email to [info@hap.org.al](mailto:info@hap.org.al) until 14<sup>th</sup> of September 2018.

The interested Companies **must participate** in the site visit to take place within **third week of September 2018**. The details of place and time of the visit will be given to the interested Companies within 17<sup>th</sup> of September 2018.

The bidding Companies should submit their offers to HAP Centre no later than end of business day on the 5<sup>th</sup> of October 2018.

The offer should include:

- Letter of interest (see Appendix 4.2);
- The BoQ Excel sheet provided with the tender documents, filled with the respective prices and totals (BoQ template provided in Appendix 2.1);
- The financial offer in correspondence with the subtotals and total amounts in the BoQ (Format provided in Appendix 2.0);
- CV of the company (with proves of the experience of the company in carrying out similar works);
- CVs of directors of the Company;
- CV of technical team directly responsible for the coordination of the works and to will be deployed to do the work sites (see Appendix 4.2 and Appendix 4.3);
- The time table of the works with a brief narrative of the timing and sequence of the jobs to be carried out (see Appendix 4, Appendix 4.1);
- Copy of the registration and license of the company;
- Copy of its status with the tax authorities and confirmation of Tax Authorities for having No obligations;
- Document from the bank as a proof of its commercial links and sound finance (within the required limit for such works, see Appendix 4.2);
- For the preparation of the offers, the companies will be obliged to visit the site, verify and make its own measurements; a short report of the visit should be added to the offer.

The application should be sent in sealed envelope no later than end of business day on the 5<sup>th</sup> of October 2018 to the address:

Subject: **REHABILITATION OF THE TWO PRIMARY HEALTH CENTRES IN VORA AND SAUK**

Procurement Team

HAP Centre

Rruga "Themistokli Germeji", Pallati Helios, Kati II, Ap.1, Tirana, Albania

E-mail: [info@hap.org.al](mailto:info@hap.org.al); Website: [www.hap.org.al](http://www.hap.org.al)



## Digjet makina në Vlorë, dyshohet zjarrvënie e qëllimshme

**VLORE** - Një makinë është përfshirë nga zjarri gjatë natës së djeshme në Vlorë. Ngarja ka ndodhur në lagjen "Dëshmorët", ndërsa mjeti tip "Benz" me targa AA007EP ka qenë i parkuar poshtë një pallati. Mësohet se ngarja ka ndodhur rreth orës 04:00 të mëngjesit, teksa automjeti ishte i parkuar në rrugë kryesore. Bëhet me dije se automjeti është në pronësi të një 27-vjeçari me iniciale R.B.. Menjëherë sapo është konstatuar zjarri, ekipet e zjarrfikës kanë mbërritur në vendngjarje dhe kanë neutralizuar flakët, pavarësisht se mjeti ishte shkrumbuar pothuajse plotësisht. Pronari i mjetit ka thënë në polici se nuk ka konflikte me njeri. Nuk dihen ende shkaqet dhe motivet e ngjarjes, por paraprakisht dyshohet se zjarrvënia ka qenë e qëllimshme.



## REPUBLIKA E SHQIPERISE

### BANKA E SHQIPERISE

### DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT

### SEKTORI I PROKURIMIT

## TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Rinovimi i suportit vjetor të HP Data Protector"**

"Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 3,450,000 Lekë**".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me parqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të kenë bërë paraprakisht pagesën e paktëshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë  
BIC: STANALTR  
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: **"Rinovimi i suportit vjetor të HP Data Protector"**

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë **04 Tetor 2018, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.



**TIRANË** - Një 35-vjeçar nga Cërriku ka ndërruar jetë ditën e shtunë në burgun e Fushë-Krujës. Mësohet se viktima është shtetasi Ervis Tako, i cili vuante dënimin në IEVP Fushë-Krujë për vjedhje. Drejtoria e Burgjeve njofton se në datë 04.09.2018 ai është dërguar nga burgu në QSUT dhe në datë 07.09.2018 është regjistruar në repartin e reanimacionit. Sipas kartelës mjekësore, 35-vjeçari vuante nga një sëmundje e pashërueshme. Ai gjithashtu ka vuajtur edhe nga sëmundje të shëndetit mendor dhe kurohej me ilaçe. Pavarësisht ndihmës së mjekëve, Ervis Thoma Tako ka ndërruar jetën ditën e djeshme në QSUT. Në datë 08.09.2018 në reanimacionin

## Shkak, një sëmundje e pashërueshme Vuante dënimin në burgun e Fushë-Krujës, ndërron jetë 35-vjeçari

### 35-VJEÇARI

Viktima është shtetasi Ervis Tako, i cili vuante dënimin në IEVP Fushë-Krujë për vjedhje. Drejtoria e Burgjeve njofton se në datë 04.09.2018 ai është dërguar nga burgu në QSUT dhe në datë 07.09.2018 është regjistruar në repartin e reanimacionit. Sipas kartelës mjekësore, 35-vjeçari vuante nga një sëmundje e pashërueshme.

in e QSUT 'Nënë Tereza' ka ndërruar jetë shtetasi Ervis Thoma Tako, 35 vjeç, lindur e banues në Cërrik, me masë sigurimi 'mjekim i detyruar',

i ndaluar për veprën penale të vjedhjes. Në datë 04.09.2018 ky shtetas është dërguar nga IEVP Krujë në QSUT 'Nënë Tereza' dhe në datë 07.09.2018

është regjistruar në repartin e reanimacionit. Sipas kartelës mjekësore, ky shtetas vuante nga një sëmundje e pashërueshme.



Ai gjithashtu ka vuajtur edhe nga sëmundje të shëndetit mendor dhe kurohej me ilaçe për shëndetin mendor. Veprimet procedurale po

kryhen nga Oficerët e Policisë Gjyqësore të Komisarariatit të Policisë Nr. 4 Tiranë", thuhet në njoftimin e Ministrisë së Drejtësisë.

Prokuroria lëshon 5 urdhërarreste, shpallen në kërkim dy minorenë

Ina Allkanjari

# Grabitja e katedrales në Korçë, bien në pranga tre të rinj

*Lihen të lirë Joni Cigare dhe Genci Arifi për mungesë provash*

Pas grabitjes së katedrales "Ngjallja e Krishtit" në Korçë, më datë 3 shtator, uniformat blu kanë bërë të mundur identifikimin dhe kapjen e autorëve. Nën akuzën e grabitjes së kasafortës së katedrales së qytetit, policia e Korçës ka arrestuar tre të rinj dhe ka shpallur në kërkim dy të tjerë. Në pranga përfunduan shtetasit Ronaldo Berberaj, 18-vjeç; Lorenc Berberaj, 18 vjeç, si dhe R.SH, 15 vjeç, banues në Korçë. Ndërkohë, po punohet për kapjen e shtetasve D.H., 15 vjeç dhe M.T., 14 vjeç. Bëhet me dije se janë lënë të lirë dy autorët e arrestuar pak ditë më parë si të dyshuar për vjedhjen e katedrales. Burime nga komisarati i Korçës konfirmojnë se janë liruar për mungesë provash Joni Cigare dhe Genci Arifi. Arrestimi i tyre erdhi pak orë pas reagimit të klerikëve ortodoksë, por policia e Korçës nuk ka pasur prova të mjaftueshme për autorësinë e vjedhjes dhe dhunimit të katedrales nga këta dy persona. Pas lirim të dy të dyshuarve për mungesë provash, prokuroria e Korçës ka lëshuar urdhër arreste për 5 personat e sipërpërmendur, dy prej të cilëve vëllezër, me precedent kriminalë. Sakaq, ndaj tre të arrestuarve pritet seanca për caktimin e masës së sigurisë për të parë nëse provat e grumbulluara nga policia krijojnë dyshim të arsyeshëm për autorësinë e vjedhjes se objektit të kultit. "Në vijim të ngjarjes së ndodhur më datë 03.09.2018, që bën fjalë për vjedhjen e një sasive lekësh në katedralen e qytetit të Korçës, specialistët e sektorit për Krimet në Komisarariatin e Policisë Korçë bënë ndalimin e shtetasve Ronaldo Berberaj, 18 vjeç; Lorenc Berberaj, 18 vjeç; R.SH, 15 vjeç, banues në Korçë. Po



Katedralja e grabitur

## Mitropolia



### GRABITJA

Më herët u bë me dije që në grabitje dyshohet se kanë marrë pjesë disa persona, të cilët janë fshehur brenda kishës dhe kanë qëndruar aty pas meshës së të dielës.

Në orët e para të mëngjesit kanë thyer dhe grabitur arkat ku besimtarët dhurojnë para dhe që Mitropolia e Korçës i përdor në ndihmë të njerëzve të nevojë. Ndërkohë, vetëm në arkën e ndihmave për të vobektit mendohet se janë përvetësuar rreth 20 mijë lekë.

punohet për kapjen e shtetasve D.H., 15 vjeç dhe M.T., 14 vjeç, banues në Korçë, bazuar në nenin 134 të Kodit

Penal", thuhet në njoftimin e policisë. Më herët u bë me dije se në grabitje dyshohet se kanë marrë pjesë disa per-

Grabitja e katedrales në qendër të qytetit të Korçës solli reagimin e Mitropolisë së Shënjtë, klerikët e së cilës e vlerësuan të pamjaftueshme punën e policisë, e cila nuk ka shkuar tek autorët e asnjë objekti kult të denoncuar si të vjedhur.

sona, të cilët janë fshehur brenda kishës dhe kanë qëndruar aty pas meshës së të dielës. Në orët e para të mëngjesit kanë thyer dhe grabitur arkat ku besimtarët dhurojnë para dhe që Mitropolia e Korçës i përdor në ndihmë të njerëzve të nevojë. Ndërkohë, vetëm në arkën e ndihmave për të vobektit mendohet se janë përvetësuar rreth 20 mijë lekë. Kujtojmë se grabitja e katedrales në qendër të qytetit të Korçës solli reagimin e Mitropolisë së Shënjtë, klerikët e së cilës e vlerësuan të pamjaftueshme punën e policisë, e cila nuk ka shkuar tek autorët e asnjë objekti kult të denoncuar si të vjedhur.

### AUTORËT E DYSHUAR

#### TË ARRESTUAR

- Ronaldo Berberaj, 18-vjeç, banues në Korçë.
- Lorenc Berberaj, 18 vjeç, banues në Korçë.
- R.SH., 15 vjeç, banues në Korçë.

#### NË KËRKIM

- D.H., 15 vjeç
- M.T., 14 vjeç

#### U LANË TË LIRË

- Joni Cigare
- Genci Arifi

## Shkak dyshohet prishja e lidhjes me vajzën

Plagos me sende të forta ish-dhëndrin në Korçë, ndalohej 54-vjeçari

**KORÇË** - Një konflikt i ashpër ka ndodhur në Korçë, ku ka mbetur i plagosur një i ri. Sipas të dhënave zyrtare nga policia, një 54-vjeçar ka plagosur me mjete të forta ish-dhëndrin e tij, pas një konflikti për motive të dobëta. Ngjarja ka ndodhur mbrëmjen e djeshme rreth orës 19:10, në fshatin Kamenicë-Korçë, ku janë konfliktuar shtetasi Nizami Bezat, 54 vjeç, banues në Kamenicë dhe ish-dhëndri i tij shtetasi S.M., rreth 25 vjeç, banues në Kamenicë. Gjatë këtij konflikti të ndodhur për motive të dobëta, Bezat, ka goditur me mjet të fortë dhe ka plagosur 25-vjeçarin, i cili aktualisht ndodhet në Spitalin e Korçës në gjendje të rëndë shëndetësore. Nuk dihen ende motivet e sakta, por dyshohet se prishja e lidhjes me vajzën e autorit dhe problemi e lindura pas ndarjes kanë qenë shkak. Autori i dyshuar i ngjarjes ndodhet i shoqëruar në Komisarariatin e Policisë Korçë, ku po kryhen veprimet e mëtejshme procedurale dhe po punohet për zbardhjen e rrethanave të kësaj ngjarjeje. Po kështu, policia ka shoqëruar edhe të afërmit dhe dëshmitarë që ndodheshin në vendin e ngjarjes kur ndodhi shërri mes autorit dhe të riut.

# PROTESTA NË DRENICË TË KOSOVËS REAGIMET

Presidenti i Serbisë mbërrin në Skënderaj, vendësit e presin me pankarta

## Vuçiç: S'e njohim pavarësinë e Kosovës, s'kemi plane për luftë

*Bekim Jashari: Kërko falje për të vrarët në luftë*

Pas mosarritjes në një marrëveshje mes Kosovës dhe Serbisë në takimin e së premtes së 7 shtatorit, një reagim vjen nga kreu i Serbisë, Aleksandër Vuçiç. "Serbia nuk do ta njohë pavarësinë e Kosovës, por as nuk do të nxisë luftë e konflikt në Kosovë", ishin mesazhet që Presidenti i Serbisë u transmetoi qytetarëve serbë të tubuar në Mitrovicën Veriore. Fjalimin e tij, Vuçiç e mbajti në përmblyllje të vizitës dyditore në pjesën veriore të Kosovës. Aty u prit nga një numër i konsiderueshëm qytetarësh serbë, ndërkohë që qyteti ishte përplot me fotografi e pankarta që i uronin mirëseardhje Vuçiçit. "Ata që deklarojnë se unë duhet të pranohet pavarësinë e Kosovës deri në fund të vitit, ju garantoj është gënjeshtër", tha Vuçiç. Sipas tij, ai po angazhohet vetëm për një zgjidhje me kompromis dhe paqësore. "Kur u thonë se dua ta ndryshoj kufirin, gënjejnë". "Në fakt unë dua që t'ju mundësoj të gjitha drejtat që ju takojnë në botën e qytetarëve", nënvizoi ai. Vuçiç tha se kishte sjellë me vete plane konkrete për investime në dhjetë komunat e Kosovës të banuara me shumicë serbe. "Se kur do të arrihet marrëveshja me shqiptarët - theksoi ai - kjo nuk mund të dihet". Por nuk e përjashtoi mundësinë që qoftë edhe pas 50 vjetësh, serbët dhe shqiptarët të jetojnë në fqinjësi dhe miqësi me njëri-tjetrin. "Nuk është vizioni im për një Kosovë pa shqiptarë apo edhe më keq, një Kosovë pa serbë", tha Vuçiç duke tërhequr vërejtjen se vizioni i tij nuk mbështetet



### BEKIM JASHARI

"Janë 15 mijë të vrarë nga lufta, 1600 persona të zhdukur. Janë 128 persona të zhdukur nga komuna jonë, kështu që me plot të drejtë po e kundërshtojmë vizitën e tij, që është një provokim dhe ringjallje e viteve të '98 dhe '99", tha Jashari.

në mite, por në realitet. Ai rikujtoi edhe fundvitet '80 dhe vitet e '90, kur kishte nisur dhe më pas ishte shpartalluar ish-Federata Jugosllave dhe fjalimet e zjarra të ish-presidentit serb, Slobodan Millosheviç. "Kënduam, kush po thotë e kush po rren, që Serbia është e vogël", tha Vuçiç. Kjo këngë dhe plot mitingje, sipas tij u

mbajtën në Knin të Kroacisë, në Sarajevë apo edhe në Prishtinë. Por, sot si në Knin, ashtu edhe në Sarajevë e Prishtinë, nga një numër i konsiderueshëm, jetojnë vetëm qindra apo mijëra serbë. "Para 30 vjetësh - theksoi ai - në Kosovë kishte tri herë më shumë serbë se sot". Ai tha se angazhohet për paqe dhe në asnjë mënyrë për

### ALEKSANDËR VUÇIÇ

"Ata që deklarojnë se unë duhet të pranohet pavarësinë e Kosovës deri në fund të vitit, ju garantoj se gënjejnë. Kur ju thonë se dua ta ndryshoj kufirin, nuk thonë të vërtetën. Në fakt, unë dua t'ju mundësoj të gjitha drejtat që ju takojnë në botën e qytetarëve", tha Vuçiç.

Vuçiçit, vizita në Banjë të komunës së Skenderajt nuk është realizuar, pasi që një grup qytetarësh shqiptarë nga kjo komunë kanë bllokuar rrugën. Shoqatat e dala nga ish-strukturat e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nga kjo komunë, të mbështetura edhe nga politikanë lokalë atje, kanë ftuar qytetarët që të dalin në rrugë që nga orët e mëngjesit, për t'i pamundësuar Vuçiçit të shkojë në fshatin Banjë. Duke iu përgjigjur kësaj ftese, qytetarët kanë bllokuar rrugën, duke vënë pengesa të ndryshme për të bllokuar qarkullimin. "Thirrjeve për protestë u janë bashkuar asamblistë dhe përfaqësues politikë nga kjo komunë. Edhe kryetari i Skenderajt, Bekim Jashari ka thënë se Vuçiç nuk mund të kalojë përmes rajonit të Drenicës, pa kërkuar falje për krimet e bëra nga forcat serbe në Kosovë gjatë luftës së fundit.



Aleksandër Vuçiç gjatë vizitës së tij në Kosovë

"Janë 15 mijë të vrarë nga lufta, 1600 persona të zhdukur, janë 128 persona të zhdukur nga komuna jonë, kështu që me plot të drejtë po e kundërshtojmë vizitën e tij, që është një provokim dhe ringjallje e viteve të '98 dhe '99", tha Jashari.

### LUFTË. QYTETARËT IA BULLOKOJNË RRUGËN VUÇIÇIT

Dita e dytë e vizitës së presidentit serb ka nisur në pjesën veriore të Kosovës, me një shtëpitje në lagjen e quajtur "Lugina e Diellit", që përfshin një projekt të qeverisë së Serbisë për ndërtimin e 300 shtëpive për kthimin dhe strehimin e rreth 1 mijë e 500 banorëve serbë të zhvendosur. Ndërkohë, njëri prej lokaliteteve në agjendën e

### SHKURT

## Kreu i Serbisë: Do ndërtojmë ura me shqiptarët, zërat për luftë janë përralla

Pas vendimit të qeverisë së Kosovës për të mos e lejuar të vizitë fshatin Banjë në Skenderaj, presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiç i është drejtuar Mitrovicës së Veriut, ku ka mbajtur edhe një fjalim. Vuçiç ka thënë se nuk ka ardhur me asnjë plan për zgjidhjen e çështjes së Kosovës, por ka premtuar se do të angazhohet për një jetë më të mirë të serbëve në Kosovë. Vuçiç i ka mohuar zërat se mund të ketë ndonjë konflikt mes shqiptarëve dhe serbëve. "Këtu para jush po them shumë hapur se s'kemi asnjë plan të zgjidhjes dhe s'jemi afër saj. Nuk jam optimist rreth kësaj. Ka 1000 të tillë që thonë që Kosova ka shkuar poshtë, por për mua nuk është poshtë, është shumë lart. Nuk dua t'i shaj shqiptarët. Nuk dua t'i shaj as ata, të cilët më kanë kërcënuar mua dhe popullin tim këtu. Ideja është të ruajmë popullin tonë, institucionet dhe të ndërtojmë ura me shqiptarët. Të tjerat na dërgojnë në katastrofë. Duhet të jetojmë pranë njëri-tjetrit dhe prandaj do të bisedojmë. Në të ardhmen duhet të arrijmë kompromis me shqiptarët. Zërat për luftë me njëri-tjetrin janë përralla. Dua diçka të kërkoj nga ju. I duheni Serbisë të qëndroni në pronat e juaja. Kjo rrugë është para nesh, që nënkupton ardhmërinë e fëmijëve tuaj", tha ai. Vuçiç tha se ka ardhur këtu për një plan intensiv në komunat e veriut. "Do të investojmë në çdo vend ku serbët janë shumicë, por edhe atje ku janë pakicë. Ditët dhe javët në vijim do t'i kemi të gjitha investimet, të cilat i premtova këtu", tha presidenti serb. Vuçiç u shpreh se: "Kur të kemi diçka në të ardhmen për të thënë, nuk do ta them në Beograd, por do të vij këtu tua them".

## Kreu i Kuvendit të Kosovës: Të përgatitemi për sfidat që na presin

### Kadri Veseli: Presidenti Vuçiç vazhdoi retorikën e Millosheviçit, promovoi veten

Kadri Veseli, kryetari i Kuvendit të Kosovës, ka thënë se Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiç edhe me këtë vizitë dëshmoi se liderët e Serbisë po vazhdojnë traditën e Slobodan Millosheviçit. Veseli tha se ai nuk ka ardhur për të ndihmuar e mbrojtur serbët në Kosovë, por për të promovuar veten, si gjithmonë me retorikë të vjetër dhe kundër të ardhmes paqësore. Veseli përmes një postimi në "Facebook" ka sqaruar se lejimi i qëndrimit të Vuçiçit tek Liqeni i Ujmanit ka ardhur pas kërkesës së partnerëve ndërkombëtarë, por sipas tij, presidenti serb e keqpërdori edhe këtë leje, duke demonstruar mbi pendën e Ujmanit logjikën e hegjemonisë politike. "Paqja dhe fqinjësia e mirë kanë qenë dhe mbështetja qëllime themelore të shtetit të Kosovës. Kosova beson se rruga e dialogut dhe bashkëpunimit është alternativa e vetme e mundshme për të tejkaluar mospajtimet

nga e kaluara dhe për të ecur përpara në rrugën euroatlantike. Në frymën e këtyre parimeve, ne kemi marrë vendim që të lejojmë vizitën e Presidentit të Serbisë. Në bazë edhe të traditës shtetërore, nuk kam dashur të deklarohej para përfundimit të vizitës së tij në Kosovë. Dua të theksoj se kam qenë kundër vizitës së tij në Ujman, pasi kam konsideruar se në veprim i tillë nuk i kontribuon paqes dhe dialogut në këtë kohë. Por, me insistimin e partnerëve tanë ndërkombëtarë, elejuam. Konsideroj se demonstrimi mbi pendën e Ujmanit ka qenë demonstrim i pastër i logjikës së hegjemonisë politike, por po ashtu edhe kundër çdo rregulli të sigurisë, pasi nuk ka



asnjë lloj praktikë demokratike që garanton masa të sigurisë për të mbajtur konferencë shtypi mbi pendë", shkruan Veseli. Gjithsesi, kreu i Kuvendit të Kosovës thotë se vizita e tij është mirë që ndodhi, sepse edhe një herë u dëshmuua se liderët e Serbisë po e vazhdojnë traditën e Slobodan Millosheviçit. "Se ata nuk vijnë për të ndihmuar e mbrojtur serbët në Kosovë, por vijnë për ta promovuar veten.

Si gjithmonë me retorikë të vjetër dhe kundër së ardhmes paqësore. Tentimet për të bllokuar në ecjen tonë, vizitat e shpeshta me tone provokuese në këto 19 vjet, na dëshmojnë se ne duhet të mendojmë dhe angazhohemi edhe më shumë për forcimin e shtetit të Kosovës. Ne tani jemi në një fazë tejet të rëndësishme të dialogut me Serbinë. Zhvillimet e këtyre dy ditëve lidhen me fazën finale të dialogut dhe duhet të na bëjnë bashkë të gjithëve që të jemi sa më të përgatitur për sfidat që na presin", deklaroi Veseli. Sipas tij, Kosova, qytetarët e saj, edhe sot e kanë dëshmuar se nuk kanë asgjë kundër serbëve.





**GREG DELAWIE**

Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, Greg Delawie ka reaguar pas vizitës së presidentit serb Aleksandar Vuçiq, në veri të Kosovës. "E pranoj se ka qenë një fundjavë e vështirë. Vlerësoj përpjekjet e bëra për të ruajtur sigurinë. Duhet të vazhdohet që të punohet shumë për të zvogëluar tensionet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Shpresoj se kjo fundjavë do të shihet si një pikë kthese pozitive", ka shkruar Delawie në "Twitter".

**Anulimi i vizitës së Vuçiqit në Skënderaj, reagon BE**

Qeveria kosovare bllokoi kalimin e presidentit serb, Kocijançiq: Ruani paqen në vend

Pas vendimit të qeverisë së Kosovës që të mos lejojë presidentin serb, Aleksandar Vuçiq të vizitojë fshatin Banjë në komunën e Skënderaj të rrugës nga qytetaret, ka reaguar Bashkimi Evropian. Zëdhënësjja e BE-së, Maja Kocijançiq tha se Bashkimi Evropian shpreh keqardhje për vendimin e autoriteteve të Kosovës. "Kërkojmë nga të gjithë përgjegjësit që të garantojnë sigurinë dhe qarkullimin e lirë gjatë ditës në rrugët e vendit. Angazhimi i plotë për ruajtjen e paqes dhe sigurisë në Kosovë dhe popullit serb, mençuria dhe qetësia janë ato që nevojiten në këto momente", ka thënë Kocijançiq.

**MAJA KOCIJANÇIQ**

"Kërkojmë nga të gjithë përgjegjësit që të garantojnë sigurinë dhe qarkullimin e lirë gjatë ditës në rrugët e vendit. Angazhimi i plotë për ruajtjen e paqes dhe sigurisë në Kosovë dhe popullit serb, mençuria dhe qetësia janë ato që nevojiten në këto momente", ka thënë Kocijançiq.

"O sot o kurrë", presidentit serb i zënë "pritë" në veri të Kosovës

# Protestat, Haradinaj i anulon lejen Vuçiqit

Thaçi kundër protestuesve: S'na ndihmon për paqen

Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq zhvilloi vizitën zyrtare në veri të Kosovës. Mëngjesin e djeshëm qytetarë të shumtë në Skënderaj kanë bllokuar aksin rrugor Skënderaj-Mitrovicë, në kundërshtim të vizitës së presidentit serb, Aleksandar Vuçiq në fshatin Banjë. Protestuesit kanë vendosur kamionë, dru dhe objekte të tjera duke bllokuar rrugën që çon për në fshatin Banjë të kësaj komune. Në protestë është parë edhe zyrtari i PDK-së, Gani Koci. Shqatrat e dala nga lufta kanë njoftuar që më parë për protestën.

**NJOFTIMI I PLOTË:**

"Nga shqatrat e dala nga lufta e UÇK-së dega Skënderaj. Të nderuar qytetarë të Skënderajt, veçanërisht luftëtarë, invalidë dhe familjarë të dëshmoreve. Fillimisht ju kërkojmë falje që po iu shqetësojmë në këto orë të vona, por sa po morëm lajmin se Aleksandar Vuçiq do të shkelë tokën e Drenicës. Andaj duke ju kërkuar secilit mirëkuptim në një ditë vikendi për shqetësimin tuaj, na falni por duhet t'ju ftojme në protestë, sepse po vjen pa kërkuar falje një president i një shteti që ka vrarë, masakruar dhunuar popullatën e pa fajshme nga foshnja e posalindur deri tek moshata e thyer, zgjuani në këmbë të gjithë ta ndalojmë Vuçiqin që të mos shkelë në tokën e Drenicës. Asnjë zyrtar i shtetit serb që ka shkakuar dhunë dhe vuajtje në Kosovë nuk do të duhej të lejohej të hynte në Kosovë



**RAMUSH HARADINAJ**

"Siguria e qytetarëve është mbi të gjitha. Kam kërkuar tërheqjen për lejen e dhënë nga Ministria e Punëve të Jashtme për vizitë të presidentit serb në zonën e Drenicës. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë", - ka shkruar Haradinaj.

testës dhe bllokimit të rrugës në aksin rrugor Skënderaj-Mitrovicë, në kundërshtim të vizitës së presidentit serb, Aleksandar Vuçiq në fshatin Banjë, nuk ka ndënjur pa reaguar dhe presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi. Përmes një statusi në "Facebook", Thaçi thotë se e mirëkupton plotësisht reagimin e qytetarëve të Drenicës, por se në kohën kur është duke bërë përpjekje për paqe dhe pajtim, protestat dhe bllokimi i rrugëve nuk ndihmojnë.

**Agjenda e Vuçiqit në ditën e dytë të vizitës në veri të Kosovës:**

- Në orën 08:00** viziton Qendrën Shëndetësore në Mitrovicë.
- Në orën 08:30** do të qëndrojë sërish në Zvečan.
- Në orën 09:15** do ta vizitojë fshatin Banjë.
- Në orën 11:15** do të qëndrojë sërish në Mitrovicë.
- Në orën 13:00** do të largohet nga Kosova përmes pikës kufitare në Jarinje.

Të premtën Vuçiq ka qëndruar në Zubin Potok, Gazivodë, Leshak, Leposaviç e Zvečan. Ndërkaq, pas pro-

testës dhe bllokimit të rrugës në aksin rrugor Skënderaj-Mitrovicë, në kundërshtim të vizitës së presidentit serb, Aleksandar Vuçiq në fshatin Banjë, nuk ka ndënjur pa reaguar dhe presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi. Përmes një statusi në "Facebook", Thaçi thotë se e mirëkupton plotësisht reagimin e qytetarëve të Drenicës, por se në kohën kur është duke bërë përpjekje për paqe dhe pajtim, protestat dhe bllokimi i rrugëve nuk ndihmojnë.

Statusi i plotë: "Qeveria e Republikës së Kosovës, ditë më parë kishte miratuar kërkesën për vizitë të Presidentit të Serbisë në Kosovë, duke përfshirë itinerarin e saktë. Por, për shkak të rrethanave të reja të krijuara dhe ruajtjes së sigurisë së qytetarëve dhe të vetë delegacionit të presidentit serb, sot qeveria e Kosovës ka marrë vendim për anulimin e viz-

itës së tij në fshatin Banjë. Si President i Kosovës, e mirëkuptoj plotësisht reagimin e qytetarëve të Drenicës, të cilët kanë shprehur revoltën e tyre të arsyeshme kundër një vizite të tillë. Kjo tregon se plagët e dhimbjes dhe luftës, janë ende shumë të freskëta. Megjithatë, në kohën kur jemi duke bërë përpjekje për paqe dhe pajtim, protestat dhe bllokimi i rrugëve, aspak nuk na ndihmojnë. Prandaj, unë e kuptoj edhe zgënjimin e banorëve të komunitetit serb në fshatin Banjë, për pamundësinë e realizimit të kësaj vizite. Të gjithë duhet të përmbahemi dhe të tregojmë kulturë minimale njerëzore të mirëkuptimit dhe komunikimit njerëzor. Ne duhet të dimë të ngrihem mbi vetveten, mbi plagët dhe dhimbjet e shumta. Duhet ta bëjmë këtë për hir të paqes dhe pajtimit". Nga ana tjetër, kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj ka kërkuar nga Ministria e Jashtme e Kosovës që të tërheqë lejen e dhënë për vizitë të presidentit serb, Aleksandar Vuçiq në zonën e Drenicës. Përmes një postimi në "Facebook", Ramush Haradinaj thotë se siguria e qytetarëve është mbi të gjitha. "Siguria e qytetarëve është mbi të gjitha. Kam kërkuar tërheqjen për lejen e dhënë nga Ministria e Punëve të Jashtme për vizitë të presidentit serb në zonën e Drenicës. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë", - ka shkruar Haradinaj. Vendimi i kryeministrit Ramush Haradinaj vjen pas protestës së qytetarëve në zonën e Drenicës. Ata bllokuan aksin rrugor Skënderaj-Mitrovicë, në kundërshtim të vizitës së presidentit serb Aleksandar Vuçiq në fshatin Banjë. Protestuesit vendosën kamionë, dru dhe objekte të tjera duke bllokuar rrugën që çon për në fshatin Banjë të kësaj komune, të cilin Vuçiq kishte planifikuar ta vizitonte në orën 09:15.

**Mediat: Polica kosovare ndalon Vuçiqin të shkojë në Drenicë**

## Anulimi i lejes nga Kosova, reagon kreu i Serbisë: Do kaloj nga rruga dytësore

E dhe pse është bërë ndalesa nga qeveria e Kosovës si dhe protestat e bllokimi i rrugës nga qytetarët në Drenicë, Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq u nis drejt Drenicës për të vizituar fshatin Banjë në Skënderaj, por është ndaluar rrugës nga policia e Kosovës. Siç raportojnë mediat serbe, policia e Kosovës ka ndaluar automjetin në të cilin udhëtonte presidenti Vuçiq duke mos e lejuar të shkojë në Banjë. Gazeta serbe "Novosti" shkruan se presidenti Vuçiq ka biseduar me policët, për të pro-

vuar të vazhdonte rrugën. Pavarësisht vendimit të kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinaj për anulimin e lejes që të vizitojë fshatin Banjë të Skënderajt, Vuçiq ka vendosur të provojë të shkojë atje. Ndërkaq një reagim ka ardhur edhe nga vetë Presidenti i Serbisë, Aleksander Vuçiq, pas bllokimit të hyrjes për në fshatin e Banjës. Ai ka thënë se do përdorë rrugë dytësore për të shkuar në Banjë, në kuadër të vizitës dyditore në veri të Kosovës. "Do të provojmë përmes rrugëve dytësore të shkojmë, por vështirë se do t'ia dalim", ka

thënë Vuçiq, transmeton televizioni serb, "RTS". Ai ka porositur gazetarët e mediave serbe që të mos shkojnë me të, por të qëndrojnë në Mitrovicë. Presidenti serb duke folur për protestën dhe bllokadën e rrugëve në Drenicë tha se gjërat duhet të zgjidhen me fjalë. "Unë jam duke u angazhuar fuqimisht në ruajtjen e paqes ndërmjet popullit të Kosovës dhe Serbisë. Gjërat duhet të adresohen me fjalë dhe me mendje, jo me mjete të ndryshme dhe armë", - tha Vuçiq.

# ARRATISJE FUNDJAVE,

"Daily Mail":

## Tirana, mes 10 qyteteve që duhen vizituar

**E**përditshmja britanike "Daily Mail" ka listuar kryeqytetin shqiptar, Tiranën, si një nga destinacionet që nuk duhen humbur për t'u vizituar, pasi kostoja e udhëtimit është e lirë. Tabloidi britanik ka listuar Tiranën në vendin e 7 mes 10 qyteteve ku arrihet me fluturim direkt nga aeroportet angleze për një "arratisje" të shkurtër. "Ndoshta një destinacion i pazakonshëm për një pushim fundjave, kryeqyteti i Shqipërisë u përshatet atyre me dell aventuresk. Krahas vizitimit të muzeut historik dhe xhiros me tur përgjatë bulevardit "Dëshmorët e Kombit" me ndërtesat e tij të epokës komuniste, rekomandohet edhe një udhëtim në "Bunkart". Ky është një muze arti bashkëkohor dhe historie moderne i ndodhur brenda një ish-bunkerit. Në sheshin "Skënderbej" do të gjeni edhe pallatin e Operas", shkruan "Daily Mail". Si një arsye pse qytetarët duhet ta ndër marrin këtë udhëtim, gazeta përmend fluturimet "low-cost" nga Londra në Tiranë. Së bashku me kryeqytetin, vendet e tjera në listë janë Dole në Francë, Kosice në Sllovaki, Aarhus në Danimarkë, Varshava në Poloni, Rovaniemi në Finlandë, Lviv në Ukrainë, Bari në Itali, Bourgas në Bullgari dhe Izmir në Turqi.



### DESTINACIONI

Tabloidi britanik ka listuar Tiranën në vendin e 7 mes 10 qyteteve ku arrihet me fluturim direkt nga aeroportet angleze për një "arratisje" të shkurtër. Një destinacion i pazakonshëm për një pushim fundjave.

**BalkanWebj.com**

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE. LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA, ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.



MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ CELULAR SMARTPHONE OSE TABLET



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

**BalkanWeb.com**  
**BW**

FALAS



### Fibank Albania hap degën në Sarandë

Dega Sarandë është e treta e hapur nga Fibank gjatë kësaj periudhe si pjesë e strategjisë së zgjerimit dhe rritjes së biznesit në Shqipëri. Fibank Albania po zgjerohet në tregun shqiptar me mbështetjen e fuqishme të Grupit rajonal Fibank. Strategjia e zgjerimit synon punësimin e kapaciteteve profesionale, kredidhënien dhe suportin për bizneset e mira si edhe ofrimin e të gjitha produkteve e shërbimeve bankare për klientët individë. Fibank Albania është në zhvillimeve pozitive dhe të rritjes së mëtejshme e bazuar në përpjekjet e vazhdueshme në ofrimin e produkteve inovative dhe të përshatëra për çdo tip klienti.








## MJEKU POPULLOR



Ylli Merja: Rruga alternative që ndalon procesin degjenerativ të gonartroza

## KESHILLA



Rëndësia e aktivitetit fizik gjatë shtatzënisë

# Rezar Rusi:



◆ Mjeku urolog:  
Mënyrat efektive për trajtimin dhe parandalimin e hematurisë

## Urinimi me gjak, paralajmërim i një çrregullimi serioz

"Mund të jetë shenjë e një kanceri të avancuar"

• Receta me thana për trajtimin e diabetit. Humbni kilogramët me uthull molle e limon

**Mjeku urolog: Mënyrat efektive për trajtimin dhe parandalimin e hematurisë**

# Rezar Rusi:

## Urinimi me gjak, paralajmërim i një çrregullimi serioz

*"Mund të jetë shenjë e një kanceri të avancuar"*

Voltiza Duro

**P**rania e gjakut në urinë mund të jetë një paralajmërim i çrregullimeve serioze në organizëm. Në një intervistë për suplementin "Life Pages" në "Gazeta Shqiptare", mjeku urolog dr. shk. Rezar Rusi tregon se problemet me veshkat apo infeksionet e ndryshme mund të jenë shkaktarët kryesorë të sëmundjes së njohur si hematuria. Më tej urologu thekson se kjo sëmundje mund të jetë shenjë e një kanceri të avancuar të veshkës, vezikës ose prostatës. Ndërkohë, Rusi tregon disa prej mënyrave efektive për trajtimin dhe parandalimin e hematurisë.

### Çfarë është hematuria?

Një njeri që papritur shikon gjak në urinë mund të kalojë një gjendje ankthi. Ndërsa në shumicën e rasteve, shkaktoresha të saj janë faktorë benignë, në raste të tjera ajo mund të tregojë ekzistencën e një çrregullimi serioz. Kur hematuria është e dukshme, me sy të lirë, ajo quhet hematuria makroskopike, ndërsa kur ajo konstatohet vetëm në mikroskop, quhet hematuria mikroskopike.

### Cilat janë simptomat kryesore të sëmundjes?

Shenjë e dukshme e hematurisë është pamja e urinës me ngjyrë rozë, të kuqe ose të errët si "Coca Cola". Kjo shpjegohet me prezencën e rruazave të kuqe të gjakut në të. Për të ndryshuar ngjyrën, urinës i duhet një sasi mjaft e vogël gjaku. Hemorragjia është za-

konishtë e padhimbshme. Nëse hematuria shoqërohet edhe me koagula (copa gjaku të mpiksura), ajo mund të shoqërohet me dhimbje gjatë eliminimit të tyre. Shpesh hematuria nuk shoqërohet me shenja ose simptoma të tjera. Në disa raste hematuria konstatohet vetëm me anën e mikroskopit. Kjo quhet hematuria mikroskopike. Urina mund të marrë ngjyrën e kuqe jo vetëm nga prezenca e gjakut në të, por edhe si rezultat i disa ushq-

veshkat ose pjesë të tjera të traktit urinar. Shkaqet e kësaj mund të jenë të ndryshme. Mund të përmendim infeksionet e traktit urinar, që shpesh ndodhin kur mikrobet hyjnë brenda trupit nëpërmjet uretrës dhe shumëfishohen në vezikën urinare. Edhe infeksionet e veshkave që mund të ndodhin kur mikrobet hyjnë në veshka janë një tjetër shkak i sëmundjes. Gurët e vezikës dhe të veshkave mund të japin hematuria makroskopike ose mik-



meve ose medikamenteve si pankhari, manaferra ose laksativi Ex-lax. Në këto raste, ngjyra normalizohet mbas disa ditësh, megjithatë për të qenë i sigurt nëse me të vërtetë në urinë nuk ka gjak, duhet kryer një vizitë te mjeku.

### Mund të na përmendni disa prej shkaqeve kryesore të hematurisë?

Hematuria është pasojë e rrjedhjes së gjakut në urinë nga

roskopike, por kjo sëmundje mund të shkaktohet edhe nga prostata e zmadhuar apo sëmundjet e veshkave. Hematuria e dukshme mund të jetë shenjë e një kanceri të avancuar të veshkës, vezikës ose prostatës. Fatqësisht, këto sëmundje mund të mos shfaqin shenja dhe simptoma në fazën e hershme, fazë kur ato janë më të trajtueshme. Edhe anemia falciforme (një lloj anemie), e cila është një defekt i trashëguar i



Mjeku urolog, Rezar Rusi

hemoglobinës në rruazat e kuqe të gjakut, mund të shkaktojë hematuria makroskopike ose mikroskopike. Ndërkohë dëmtimet e veshkës nga aksidentet ose përplasjet sportive mund të shkaktojnë daljen e gjakut në urinë, por edhe medikamenti kundër kancerit, cyclophosphamide dhe penicilina mund të japin hematuria.

### Cilat janë disa prej faktorëve influencues në zhvillimin e sëmundjes?

Pothuajse çdo njeri mund të konstatojë gjak në urinë duke përfshirë edhe fëmijët. Faktorët që mund të influencojnë në këtë janë moshja, një infeksion i ri, historia familjare, medikamentet, ushtrimet fizike të mundimshme. Gjatë jetës së tyre, më shumë se gjysma e grave do të kenë të paktën një herë infeksion të traktit urinar e shoqëruar me hematuria. Meshkujt e rinj janë më të predispozuar për të pasur gurë në veshka ose sindromin Alport, një nefrit i trashëguar, të cilat mund të shoqërohen me hematuria.

### Si bëhet diagnostikimi i hematurisë?

Ekzaminimi fizik përfshin dhe diskutimin e historisë familjare. Përveç rruazave të kuqe, analiza e urinës mund të vërë në dukje një infeksion të traktit urinar ose prezencën e mineraleve që shkaktojnë gurë të veshkave. Në ekzaminimet imazherike përfshihet CT skaneri, rezonanca magnetike ose eko e aparatit urinar. Ndërsa cistoskopia konsiston në futjen e një tubi të hollë, i pajisur me një kamerë në vezikë, për të parë nga afër vezikën dhe uretrën me qëllim gjetjen e shkaktarit. Ndonjëherë shkaku i hematurisë nuk mund të zbulohet. Në këto raste rekomandohet një ndjekje e vazhdueshme sidomos kur ekzistojnë faktorë predispozues për kancerin e vezikës si duhani, ekspozimi ndaj toksinave të mjedisit ose

mjekimi me rreze.

### Si realizohet trajtimi i sëmundjes?

Vetë hematuria nuk ka një trajtim të veçantë. Mjeku përqendrohet në trajtimin e shkaktoreshave. Këtu mund të përfshihet: përdorimi i antibiotikëve për çrrënjosjen e infeksionit të traktit urinar, përdorimi i medikamenteve për zvogëlimin e një prostate të zmadhuar, mënyra të ndryshme për heqjen e gurëve nga vezika urinare ose veshkat. Nëse shkaktoresha e hematurisë nuk janë serioze, trajtimi s'është i domosdoshëm.

### Si mund të parandalohet sëmundja?

Në përgjithësi nuk është e mundur të parandalosh hematurinë, megjithatë ka disa veprime që pakësojnë rrezikun e disa sëmundjeve që e shkaktojnë atë. Për të pakësuar rrezikun e infeksioneve të traktit urinar, rekomandohet pirja e sasive të mëdha të lëngjeve, të zbrazet urina kur ke ndjenje urgjente për të urinuar si dhe të urinohet mbas kontaktit seksual. Femrat duhet të fshihen mbas urinimit në drejtim nga mbrapa përpara. Të evitohet përdorimi i prodhimeve higjienike femërore, që mund të iritojnë organet gjenitale. Për të pakësuar mundësinë e krijimit të gurëve duhen pirë sasi të mëdha lëngjesh, të kufizohet përdorimi i kripës, proteinave dhe ushqimeve që përmbajnë oksalate si spinaqi dhe panxhari. Rreziku i kancerit të vezikës mund të pakësohet duke ndërprerë pirjen e duhanit, duke evituar ekspozimin në mjedis me kimikate dhe duke pirë sasi të mëdha lëngjesh. Për të parandaluar formimin e kancerit të veshkës duhet të ndërpritet duhani, të mbahet një peshë trupore normale, të përdoret dietë e shëndetshme, të bëhet jetë aktive dhe të shmanget ekspozimi në mjedis me substanca toksike.




Voltiza Duro

**G**onartroza është një sëmundje kronike, de gjenetuese, progresive. Vjen nga një ngjarje mekanike dhe biologjike, që destabilizon lidhjen normale të nyjave artikulare. Gonartroza është sëmundja që prek pothuajse 90% të popullsisë rreth 40 ose 50 vjeç me një mbizotërim më të madh të grave. Mund të ketë inflamacion të membranës sinoviale në disa raste. Zakonisht, fillimi i saj është i njëanshëm, me një tendencë të bëhet dypalëshe me kalimin e kohës. Gjuri ndahet nga një ndarje e brendshme, e jashtme dhe bashkimi patello-femoral. Gonartroza mund të shfaqet në pacientët me një zhvendosje të patellës, ose lidhur me një osteoartrrozë të kofshës. Së dyti, ajo mund të ndikojë tek njerëzit me një histori traumash të përsëritura, duke përfshirë thyerjet, dëmtimet e meniskëve etj. Kërci hialinë është forma mbizotëruese e kërcit të kyceve që mbulon skajet e sipërfaqeve artikulare dhe funksioni i tij është të absorbojë forcën dhe ndikimin, duke siguruar një koeficient të ulët të fërkimit dhe përmirësimin e stabilitetit. Kur ka një rritje në presionin e kontaktit të aplikuar në gju, ndryshimet ndikojnë në kërc dhe shkaktojnë fragmentimin e rrjetit të fibrave të kolagenit. Sëmundja ndikon në të gjithë kërcin, ligamentet dhe muskujt periarticular. Ngarkesa, presioni dhe fërkimi në gjunjë dëmtojnë kërcin e gjurit, degjenerojnë atë në mënyrë progresive deri në arritjen e shtresave të thella të kockave. Kjo bëhet më e dukshme dhe mund të vërehet formimi i osteofiteve, kisteve dhe ngurtësimeve. Në etiologjinë e gonartrozës ekzistojnë dy shkaqe kryesore: primare dhe sekundare.

#### Simptomat

Simptoma karakteristike është dhimbje e njëanshme, por mund të ndodhë që të jetë dhe bilaterale. Shfaqet ngurtësi me një kohëzgjatje të shkurtër. Shumica e simptomave përkeqësohen me aktivitetet dhe peshë dhe qetësohen në pushim. Pacienti mund të ankohet për ngurtësi në këmbë, e cila është zakonisht me një kohëzgjatje të shkurtër (rreth 15 deri 30 minuta). Në klimat e lagështa dhe të ftohta ngurtësia është më e fortë dhe mund të zgjasë pak më gjatë. Kufizimet e lëvizjeve dhe kërcitja janë gjithashtu karakteristike dhe simptoma të shpeshta të osteoartrrozës në gju. Kërci ka mbarsa nervore dhe me prekjën e tyre shpjegohet ekzistenca e dhimbjes edhe si manifestim fillestar, por ka edhe shkaqe të tjera të mundshme që shpjegojnë dhimbjen, të tilla si procesi inflamator i membranës sinoviale si rezultat i një rritje në aktivitetin e pacientit. Kërcitja mund të jetë e perceptueshme nga pacienti ose mund të ndihet me dorë dhe nganjëherë, mund të jetë e dëg-



**Mjeku popullor: Kujdes, mos neglizhoni këto simptoma! Si bëhet diagnostikimi**

## Ylli Merja: Rruga alternative që ndalon procesin degjenerativ të gonartroza

*"Përzjerja bimore që do të luftojë dhimbjet e gjurit"*



Mjeku popullor  
Ylli Merja

jueshme. Veçanërisht në fazat e avancuara, shihet lëvizje e kufizuar për shkak të mospërpjethjes së sipërfaqeve të përbashkëta nga ana e procesit shkatërrues. Dobësimi muskular është zbuluar nga ekzaminimi fizik shpesh për shkak të mospërdorimit, veçanërisht të muskullit më të madh të kofshës pra quadricepsit.

#### Diagnoza

Testet laboratorike dhe testet e aktivitetit reumatik nuk janë definitive në diagnozë. Studimet radiografike konfirmojnë diagnozën e gonartrozës. Bëhet radiografi dhe në raste të ndërlikuara CT dhe MRI.

#### Trajtimi

Për shkak të shumëllojshmërisë së simptomave, ekzistencës së fazave të ndryshme të sëmundjes dhe proceseve të ndryshme patologjike të tilla si degjenerative dhe nxitëse, bëjnë që trajtimi i gonartrozës të jetë i ndryshëm, kompleks dhe multidisiplinar. Edukimi i pacientit është me rëndësi vitale në mënyrë që ndryshimi i stilit të jetesës të jetë efektiv. Ushtrimet duhet të tregohen për të mbajtur një gamë lëvizjesh në mënyrë që kontrakturat të parandalohen ose zvogëlohen. Përdorimi i këpucëve të përshatshme, kryesisht ato që shpërndajnë ngarkesën, ndihmon procesin.

#### FAKTORET

- Faktorë primarë të rrezikut
- Ndryshime metabolike që çojnë në procese degjenerative.
- Faktorë gjenetikë.
- Deformime të lindura si gjunjët varus dhe valgus.
- Faktorë sekundarë
- Obeziteti.
- Punët që kërkojnë një kohë të gjatë.
- Ngritja e objekteve të rënda.
- Diabet mellitus.
- Artrit septik.
- Dëmtime traumatike.

dhe bëjmë masazh për 10-15 minuta nga kavigjaja drejt kofshës. Pas lyerjes, mund të bëni terapinë ushtrimore për 15 minuta. Pas 30 minutave mbështillni gjurin me qepë të shtypur dhe lëreni për 2-3 orë. Qepa ka vetinë të tërheqë inflamacionin dhe toksinat pasi është një antiooksidantë shumë efektiv (kjo në rastet kur shfaqet ënjtje në gju). Në darkë lyejmë këmbët me ekstraktin e variceve dhe pasi thahet vendosim vajin e sinapit. Gjatë ditës pini 1-2 lugë kafe vaj sinapi.

#### Trajtimi me bimë medicinale

Ky trajtim konsiston në nxitjen e organizmit për prodhimin e lëngut sinovial dhe shmangien e degjenerimit të strukturave kërcore të gjurit. Pra, do të përdoren bimë që nxitin qarkullimin e gjakut dhe që përmbajnë minerale. Bimë të tilla si: hithra, trëndafilli i egër, këputja, murrizi, dëllinja mund të kombinohen dhe të na japin efektin e dëshiruar. Përzjerja me bimë forcon gjurin dhe strukturat përreth. Në 2 litra ujë zieni për 2 minuta: një pako çaj reumatizme, një dorë lule murrizi, një dorë lëvore shelgu, një lugë gjelle dëllinjë dhe pini 3x1 gotë në ditë nga ky çaj para buke. Në rastet e ndërlikuara ku kemi bllokim të qarkullimit të gjakut përdorim dhe safranin me fije. Ai përdoret 2 herë në ditë nga 10 fije duke e hedhur në ushqim. Duke kryer në mënyrë të duhur kurën e mësipërme, ju nuk do të ndjeni më dhimbje dhe do shmangni degjenerimin e kërcëve artikulare.

Ushtrimet e planifikuara duhet të individualizohen duke përfshirë ngritjen e këmbëve, lëvizje rrotulluese të tij, ulje ngritje, ngritja në majë të gishtave, lëvizjet majtas-djathtas etj.

#### Mjekësia alternative

Kura më e mirë për të trajtuar gonartrozën përfshin një shumëllojshmëri elementesh. Fillimisht pacienti duhet të bëjë lyerje nga kavigjaja drejt gjurit 2 herë në ditë me ekstraktin e variceve që nxit qarkullimin e gjakut. Pasi thahet vendoset vaji e sinapit që është një qetësues, zbutës dhe rigjenerues i strukturave të dëmtuara.

Në mëngjes lyejmë këmbën me ekstrakt e variceve dhe pas 5 minutave vendosim vajin e sinapit

**G**jatë pritjes së ëmbël të një bebi, trupi gruas dhe rezistenca e saj ndryshojnë shumë. Shtatzënia është për të marrë ajër dyfish, jo për të ngrënë dyfish. Që do të thotë për një grua në këtë periudhë ka shumë rëndësi të furnizojë trupin me oksigjen. Edhe aktiviteti fizik e ndihmon që të rrisë oksigjenin në organizëm edhe të ulë përqindjen e yndyrnave. Normalisht qëllimi stërvitjes në këtë periudhë ndryshon, ju nuk stërviteni thjesht për të mbajtur trupin në formë por për një sërë faktorësh të tjerë.

**Përfitimet nga aktiviteti fizik gjatë shtatzënisë**

Aktiviteti në këtë periudhë fokusohet te tendosja e trupit. Largon stresin dhe ndikon në gjendjen tuaj sepse gjatë aktivitetit, trupi lëshon hormonin e endorfinës, i cili përmirëson gjendjen tuaj emocionale. Gjithashtu, ju ndihmon të kontrolloni peshën duke ju përgatitur për fazën e lindjes. Edhe gjatë fazës kur lind fëmija, ju jeni më të përgatitur nga ana muskulare sepse lirohen muskujt e mitrës. Gjithashtu, për shkak të kujdesit që ju keni treguar gjatë shtatzënisë me ushqimin dhe aktivitetin, fëmija lind me një peshë normale. Ju do të ndje-

“Noti mbetet një nga llojet e aktiviteteve më të parapëlqyera kur je shtatzënë. Për arsyen e vetme sepse nuk ndjeni peshën tuaj. Mund të notoni dhe mund të bëni disa ushtrime të thjeshta në ujë.



# Rëndësia e aktivitetit fizik gjatë shtatzënisë

heni më mirë në përgjithësi, duke pasur më pak dhimbje shpine edhe këmbët do i ndjeni më të forta pasi qarkullimi i gjakut mundësohet më mirë. Aktiviteti fizik ju mban larg sëmundjeve që mund të shfaqen gjatë shtatzënisë. Por një problem është edhe rikthimi në gjendjen para shtatzënisë, edhe kush është bërë nënë e di shumë mirë vështirësinë. Por, nëse ju keni kryer aktivitet fizik para shtatzënisë edhe gjatë asaj periudhe e keni vazhduar sërish, rikthimi në linjat e mëparshme do të jetë shumë herë më i lehtë sesa i një nënë që nuk është

marrë asnjëherë me aktivitet. Por nënat e neglizhojnë shumë këtë pjesë sepse mendojnë që të merresh me aktivitet kur je shtatzënë mund të ketë rrezikshmëri. Sipas studimeve të fundit, aktiviteti është shumë i rëndësishëm në shtatzëni dhe mundësia për rrezikshmëri është shumë e vogël nëse merr konsultat e duhura. Prandaj unë ju sugjeroj që në fillim të konsultoheni me mjekun edhe më pas me instruktorin tuaj. Sigurohuni që instruktori është profesionist edhe është duke ju dhënë këshillat e duhura.

**Noti**

Noti mbetet një nga llojet e aktivitetit më të parapëlqyera kur je shtatzënë. Për arsyen e vetme sepse ju nuk ndjeni peshën tuaj. Mund të notoni edhe mund të bëni disa ushtrime të thjeshta në ujë. Ecja: Bëhuni sa më aktive kur jeni në këtë periudhë. Ecja është një tjetër alternativë. 30-40 minuta në ditë do ju ndihmonin shumë për të marrë të mirat e aktivitetit fizik.

**Joga**

Joga mbetet një nga mënyrat më të mira që ju të jeni elastik edhe të kujdeseni për trupin edhe gjatë shtatzënisë. Yoga ju ndihmon që të keni një lindje sa më të lehtë sepse lirohen muskujt e mitrës.

**Kegel**

Muskujt e legenit dobësohen nga lindja, shtatzënia, mbipësia dhe moshë. Ushtrimet kegel ndihmojnë për të kontrolluar problemet me dyshemëni pelvike ose mospërmbajtjen urinare. Ushtrimi kegel bëhet duke kontraktuar muskujt e dyshemës pelvike, që do të thotë ju bëni sikur ndaloni urinimin duke kontraktuar këta muskuj. Përsëriteni 4 herë me 5 sekonda duke u relaksuar nga 10 sekonda midis përsëritjeve. Këto ushtrime ju ndihmojnë edhe në arritjen e orgazmës edhe janë pjesë e terapipe seksuale.

**Palestër**

Në palestër mund të bëni ushtrime që ju ndihmojnë me shtendosjen e muskujve, po ju ndihmojnë të largoni dhimbjet e shpinës. Por edhe shumë ushtrime të tjera përkatëse të një niveli të ulët deri në mesatar përta i përket shkallës së vështirësisë. Gjatë aktivitetit fizik në shtatzëni nuk duhet ta rrisni shumë temperaturën e trupit. Një test i thjeshtë që mund të bëni është e folura. Nëse flisni pa ju marrë frymë gjatë ushtrimeve do të thotë se gjendja është në rregull, nëse ju merret frymë gjatë ushtrimeve kjo do të thotë se jeni duke u lodhur shumë. Këto ishin disa alternativa, ju mund të zgjidhni të preferuarën dhe të filloni. E rëndësishme është mos bëni një lloj aktiviteti që nuk ju pëlqen, sepse në këtë periudhë, aktiviteti duhet të jetë edhe një terapi mendore përveçse fizike.





# Këshilla

## Receta me thana për trajtimin e diabetit

**K**rahas shijes së tyre, thanat janë ndër frutat më të veçanta medicinale me përdorim të gjerë në mjekësinë popullore. Falë vlerave të tyre fantastike për shëndetin, thanat përdoren në shumë kura të ndryshme për shërimin dhe trajtimin e disa sëmundjeve, prej të cilave edhe problemet me diabetin. Thanat gjithashtu shërben si një produkt bazë për të mbajtur të stabilizuar nivelin e sheqerit në mënyrë natyrale. Po japim më poshtë dy mënyra efektive të përdorimit të thanave për të parandaluar problemet me diabetin.

### Kura me 15 kokrra të freskëta thana

Thanat kanë sezon të shkurtër ndaj përfitonin sa më shumë prej tyre. Për një periudhë 30-ditore apo edhe më shumë rekomandohet konsumimi i të paktën 15 kokrra thanave pas vaktit të mëngjesit.

### Kura me lëngun e thanave

Për këtë kurë do t'ju duhet 1 kg thana dhe 2.5 litra ujë. (Sasia e përbërësve rritet bazuar në sasinë e lëngut që dëshironi të përgatitni). Lajini thanat dhe vendosini në një tenxhere bashkë me ujin. Duhet t'i lini të ziejnë përreth 1 orë. Më pas fikni sobën, përmes një luge druri shtypni frutat e thanës dhe lërinin me kapak të mbyllur derisa të ftohen. Më pas, kulloni lëngun e thanave, vendoseni në shishe apo kavanoz qelqi të pastruar mirë dhe ruajeni në frigorifer. Konsumoni



nga një filxhan kafeje me lëng thane herët në mëngjes çdo ditë për një periudhë 30-ditore.

### Përdorime të tjera mjekësore të thanës

Fruti i thanës është përdorur për të ulur temperaturën dhe për të luftuar disa çrregullime të zorrëve. Thartësira karakteristike e

këtij fruti e bën atë mjaft të dobishëm në luftën kundër sëmundjeve kardiovaskulare. Thanat janë përdorur edhe për t'u kuruar nga diarreja e mund t'i ruani në frigorifer për disa ditë, për sa kohë i paketoni në një qese të izoluar mirë. Ato jetojnë më gjatë në formën e tyre të thatë.



## HUMBNI kilogramët me uthull molle e limon

**R**ënia në peshë është kthyer në një problem të përhershëm. Ekspertët janë kundër regjimeve drastike që e frenojnë njeriun nga ushqimi dhe rekomandojnë kura natyrale e të shëndetshme. E tillë është kura me uthull molle dhe lëng limoni, përfittimet e së cilës i sjellim më poshtë. Uthulla e mollës ndihmon në uljen e sheqerit në gjak, nxit ndjesinë e ngopjes, përmirëson tretjen dhe ndihmon në heqjen e kilogramëve të tepërt. Nga ana tjetër, konsumi i vetëm i lëngut të limonit nuk shkrin yndyrat e akumuluar në organizëm, por gjithsesi ofron shumë përfittime shëndetësore. Uthulla e mollës nxit rënie në peshë duke forcuar metabolizmin dhe frenuar oreksin. Përbërësi kryesor i uthullës është acidi acetik. Sa më të larta dozat e acidit acetik në organizëm, aq më e plotë do të jetë ndjesia e ngopjes pas një vakti të pasur me karbohidrate. Përveç kësaj uthulla e mollës nuk përbën problem për shqetësimet e stomakut, sidomos nëse e merrni në masën e duhur. Sa më shumë të zgjasë ndjesia e ngopjes, aq më pak kalori do të merren gjatë ditës dhe me kalimin e kohës, pesha trupore do të arrijë nivelet e dëshiruara.

### VITAMINA C DHE RËNIA NË PESHË

Lëngu i limonit ndoshta nuk shkrin yndyrat apo detoksifikon organizmin për mrekulli, por është një burim i shkëlqyer i kaliumit, vitaminës C dhe acidit citric. Nga ana tjetër, disa studime të cilave i referohet AgroWeb.org konfirmojnë se njerëzit që konsumojnë shumë vitaminë C, arrijnë të treshin më shumë yndyra në krahësim me të tjerët. Në 30 millilitra lëng limoni gjenden 7 kalori por edhe 20 për qind e vlerës ditore të nevojshme të vitaminës C.

Kivi, specat dhe agrumet janë burime të tjera të shkëlqyera të vitaminës C. Uthulla e mollës dhe lëngu i limonit janë dy substanca natyrale të cilat mund të përfshihen mjaft mirë në shumë regjime të ndryshme ushqimore. Megjithatë, kjo nuk do të thotë që pesha mund të ikë sa hap e mbyll sytë vetëm duke pirë lëng limoni apo uthulle.

Mënyra më e mirë për të humbur peshë është nëpërmjet ushqyerjes së shëndetshme dhe aktivitetit fizik. Nëpërmjet limonit, ju mund të pini më shumë ujë dhe të hidratoheni më shumë, ndërsa nëpërmjet uthullës, ju mund të fuqizoni organizmin dhe përmirësoni tretjen. Megjithatë duhet të tregoni kujdes me masat e konsumuara sepse të dyja këto lëngje janë acide dhe shkaktojnë prishjen e dhëmbëve.

### PËRGATITJA

Për të përgatitur këtë kurë mjafton që çdo ditë të shtoni në një gotë 300 ml me ujë të vaktit një lugë gjelle uthull molle dhe një lugë gjelle lëng limoni të freskët. Përziejeni mirë dhe më pas pijeni pasi të kenë ngrënë mëngjes. Provojeni për 30 ditë dhe organizmi juaj do të jetë më i lehtësuar.

Dje në 'Deutsche Welle'

# Teatri politik e cinik për Kosovën vazhdon...

Nga Adelheid Feilcke


(vijon nga faqja 1)

...duhet t'u rezistojnë furtunave, mendon Adelheid Feilcke. Për disa javë me radhë nuk ka pasur temë tjetër në Ballkan: Serbia dhe Kosova janë pak para një ujdie. Hashim Thaçi dhe Aleksandar Vučić po punojnë së bashku për një zgjidhje. As shkëmbimi i territoreve nuk përjashtohet. Pika kulture e këtij inskenimi të diskutuar në rajon e të orkestruar ndërkomëtarisht do të ishte fjalimi i presidentit Vučić para serbëve në Veriun e Kosovës. Shumë spekuluan se ky udhëtim do të ishte udhërrëfyesi i ri: pajtimi, normalizimi i marrëdhënieve dhe një bashkëjetesë paqësore, pranimi i Kosovës në OKB. Por asgjë nga këto!

## FUNDJAVË ZHGENJYESE!

Pas javësh shpresash politike, erdhi një fundjavë plot tensione politike me një fund zhgënjyes. Dialogu mes presidentit të Kosovës, Thaçi dhe atij serb, Vučić dështoi në Bruksel, sepse presidenti serb ndjehej i mashtruar nga kosovarët. Dhe fjalimi udhërrëfyës në Mitrovicën e Veriut ishte vetëm një përsëritje e pozicioneve të vjetra. Në vend të një rrugë të re, kështu duket, Vučić zgjodhi rrugën e vjetër duke e çimentuar, madje atë me fjalë të forta: Asnjë njohje të Kosovës, asnjë ndryshim kufijsh.

Çfarë ka ndodhur, që të gjitha pritshmëritë për një "deal" me gjasë mes dy presidentëve u shpërbënë kaq papritur? Ka ndodhur vërtet diçka, apo e gjitha kjo ishte një akt i ri në teatrin e njohur politik të Ballkanit? Sipas presidentit serb, duhet të ketë ndodhur diçka me peshë, sepse i ngarkuari i tij për Kosovën përdori të premtën akuzë të rënda: kosovarët e kanë gënjer dhe mashtruar Vučićin. Përse? Për këtë spekulohet shumë.



## ENDE SHUMË PIKA TË NDJESHME MES KOSOVËS DHE SERBISË

Fakt është që presidenti i Kosovës ndryshe nga ai serb ndodhet nën presion të madh të brendshëm poli-

tik, duke pasur reagime të forta si nga qeveria, ashtu edhe opozita. Po ashtu dihet, se ka shumë pika të ndjeshme mes Kosovës dhe Serbisë që duhen sqaruar derisa të arrihet një zgjidhje. Kosova kërkon

para së gjithash njohjen, ose jo bllokimin nga Serbia për pranimin në Kombet e Bashkuara. Serbia nga ana e saj para së gjithash kërkon ta zgjidhë problemin e Kosovës duke ruajtur fytyrën, me

qëllim që të ecë përpara me anëtarësimin në BE. Deri këtu në rregull, por në mes të këtyre qëndrojnë shumë çështje të hapura, sidomos sqarimi i të drejtave të minoriteteve, mbrojtja e kishave dhe monumenteve të kulturës, përdorimi i burimeve, sidomos në veri të Kosovës, e shumë të tjera. Por megjithatë, çfarë është i gjithë ky teatër? Si është e mundur, që dy presidentë njëherë tentojnë të gjejnë drejtpërdrejt një zgjidhje dhe pas kësaj, nuk rezistojnë me furtunën e parë që u del përballë për të vazhduar kursin e dialogut dhe kompromisit. Atë që e arritën me kaq sukses të dy kryeministrit e Greqisë dhe Maqedonisë, vazhdimi i kursit me gjithë erën e fortë në radhë e veta. Për fat të keq të ngjallet dyshimi, se dëshira për një zgjidhje me ujdi përmes bisedimeve direkte nuk ishte aq e pjekur. Sepse problemi i përfolur i madh i së premtes në bisedimet e Brukselit, se Kosova nuk do ta lejonte vizitën e Vučićit në Gazivodë u mënjanua përmes presionit ndërkomëtar. Edhe frika e kosovarëve se Serbia me Veriun e Kosovës kërkon të krijojë një tip Republikë Srpska do të mund të ishte sqaruar përmes negociatave të mirëmoderuara nga ndërkomëtarët.

## KOHA NUK PRET

Po si mund të përgatitet popullsia për një zgjidhje, kur politikanët kryesorë nuk janë në gjendje të përfaqësojnë së bashku një koncept. Ose të taktin një rrugë të përbashkët? E gjitha mbetet një teatër politik cinik. Tani mbetet shpresa për një ndërmjetësim intensiv evropian, si e kërkon e ngarkuara e BE-së, Federica Mogherini. Koha nuk pret, sepse vitin e ardhshëm janë zgjedhjet europiane dhe nuk është aq e lehtë e parashikueshme, se çfarë do të ndodhë pas kësaj. Porca rrezatuese e një BE-je ndërmjetësuese, që josh me anëtarësimin në BE ka kohë që është dobësuar. Pasi sot Vučić foli jo vetëm për muaj, por për vite, madje dekada deri sa të arrihet një normalizim i marrëdhënieve, shtrohet pyetja, nëse vërtet tek ai e të tjerë ekziston shtysa për një zgjidhje finale e të afërt në kohë? Por dihet se pa përfshirjen e politikanëve kryesorë në të dyja vendet, veçanërisht Vučićin në Serbi, nuk do të ketë zgjidhje. Ne duhet të përgatitemi për momente të tjera dramatike, se një fund i lumtur i këtij teatri politik është ende shumë larg.

**BLUE TOOTH**  
THASHETHEME MADE IN ALBANIA

te rejat nga jeta ipave  
çdo të shtunë falas me



Opinion i Ditës

# Shqiptarë, rrini të qetë! Kosova ka ende burra

Nga Spartak Ngjela

(vijon nga faqja 1)

...Jashari është ende gjallë, kurse këta shqiptarë, që të përgjergjen ty, janë pilivesa...".

Angela Merkel në Shkup, me fjalën e saj, e shkatërroi përfundimisht planin ogurzi të ndarjes së Kosovës.

Esadistët në Tiranë dhe në Prishtinë, sigurisht që janë në hall të madh, se menduan që me ndarjen e Kosovës të krijonin shpërbërjen e dy shteteve shqiptarë me destabilizim.

"S'ka ndarje!" - tha shefja e madh e Europës.

"Fjala e saj është ligj", tha Vuçiq nga liqeni i Kosovës, por me zë të drobitur.

Vuçiq nga Mitrovica merr në telefon Erdoganin në Stamboll. E dini cili është nënteksti i kësaj bisede?

"Rexhep, po na i marrin shqiptarët të gjitha tokat e tyre që ju na i dhatë që nga viti 1878 e deri në vitin 1913". Po cila mund të jetë ndihma që do t'i japë Erdoganin? Kuptohet: mbështetjen e Ramës dhe të Thaçit.

Po kush i pyet këta në Shqipëri! Po të shohim tani dhe djcka: si do të precipitojnë ngjarjet? Sigurisht në favor të botës shqiptare në Ballkanin Perëndimor. Në Selanik ka trazira për emrin e ri të Maqedonisë, kurse politika shqiptare në Shkup është mecece. Se është e korrup-tuar.

Blijini! Thoshte kryeministri serb për krerët e shqiptarëve, në fillim të shekullit të XX. Dhe i blenë.

Por ajo që bie negativisht sot në sy, është fakti që emigracioni shqiptar në Perëndim, edhe pse i ka sytë nga Shqipëria dhe nga Kosova, nuk është aktiv. Sot në emigracionin shqiptar në Perëndim ka njerëz me vlerë, po nuk janë aktivë. Sepse siç duket, nuk e kanë të qartë se çfarë po ndodh.

Duhet të imitojnë shqiptarët e mëdhenj të Rilindjes Kombëtare që krijuan shoqata dhe komitete në Europë, në Amerikë, madje edhe në Egjipt dhe e shpëtuan Shqipërinë nga likuidimi tërësor.

Sot është e njëjta situatë si atëherë, sepse prapë janë bërë bashkë Moska, Beogradi dhe Stambolli për të shpërbërë Shqipërinë.

Këta po i tremb shumë bota shqiptare në Ballkanin Perëndimor dhe janë hedhur në sulm me esadistët në Tiranë dhe në Prishtinë, kundër bashkimit shqiptar.

Por dita e sotme ishte një fakt i ri për ringritjen e historisë së Shqipërisë, e cila ka filluar në vitin 1999 dhe duhet të shkojë deri në albanizim real të Ballkanit Perëndimor. Dhe do të shkojë.



## HOROSKOPI

### DASHI

Shfrytëzoheni këtë ditë për të kaluar kohë kualitative në shtëpinë tuaj, pranë familjes. Do të jetë një nga ato ditët që në mënyrë të natyrshme do të jetë e bukur.

### DEMI

Jeni i vendosur për të fituar afekcionin e një personi të dashur për ju. Kohët e fundit kësaj çështjeje i keni kushtuar shumë kohë dhe energji. Sot do t'ju ecë mbarë në dashuri.

### BINJAKET

Kohët e fundit mund të keni qenë shumë i zymtë, por sot duhet të rivendosni gjendjen e mirë shpirtërore. Do të jeni më tërheqës se zakonisht duke rritur ndjeshëm shamin tuaj.

### GAFORJA

Dita paraqitet e mirë për ata njerëz që kanë imagjinatë. Nëse jeni i etur për të bërë gjëra të reja apo për të takuar njerëz të rinj, sot është dita e duhur për ta bërë këtë.

### LUANI

Është një ditë shumë pozitive. Ndiheni i qetë dhe i balancuar, por edhe shumë më tolerant se zakonisht. Bëni një pushim nga përditshmëria dhe monotonia.

### VIRGJERESHA

Njerëzit që keni përreth ju shohin si një lider dhe presin prej jush që të silleni si i tillë. Edhe kjo është në natyrën tuaj. Duhet që të përfshihen më shumë në aktivitetet që ju sjellin kënaqësi.

### PESHORJA

Sot do të jeni shumë tërheqës dhe sharmant. Fuqitë tuaja joshëse do të jenë në maksimum dhe mjaft intensive në jetën profesionale. Nëse keni dëshira dhe ëndrra, sot është dita për t'i shprehur ato.

### AKREPI

Sot do të mendoni më shumë për arritjet në fusha të ndryshme të jetës. Atmosfera është e qartë duke ju lejuar të reflektoni me mendje të kthjellët.

### SHIGJETARI

Ka të ngjarë që të merrni një surprizë të këndshme sot nga partneri juaj. Ky person do të tregojë vlerësimin që ka ndaj jush. Mund ta gjeni vetën në qendër të vëmendjes së dikujt.

### BRICJAPI

Jeni shumë pranë suksesit. Muajt e fundit kanë qenë pak të vështirë, sepse mundësitë për ju kanë qenë të kufizuara, edhe pse keni bërë shumë punë.

### UJORI

Nëse situata ka qenë e tensionuar kohët e fundit, sot gjërat do të stabilizohen. Do të jetë një ditë e qetë dhe do të shijoni momente relaksi dhe mjaft të bukura.

### PESHQIT

Sot mund të jetë një ditë me fat, veçanërisht nëse po kërkoni një raport të ri dashuror. Sot mund të njihni një person shumë interesant që mund t'ju bëjë jetën plot ngjyra.

Trajneri driblon çështjen "Kaçe": Pyesi Çarçanin përse nuk ju ka njoftuar

# Panuçi: Ndaj Skocisë do të japim më të mirën

*Italiani kërkon rezultatin pozitiv në Gllasgou*



Jeton Selimi

**K**ristian Panuçi kërkon fitoren e dytë radhazi në Nations League në krye të Shqipërisë kundër Skocisë në "Hampden Park", një stadium ku ruan një nga kujtimet më të bukura të karrierës së tij. Trajneri italian i kuqezinjve shpjegoi në konferencën për shtyp se përse e kishte grumbulluar Kaçen, duke paralajmëruar edhe ndryshime në formacion.

**A e keni vendosur formacionin dhe sa ndryshime do të ketë krahasuar me ndeshjen me Izraelin?**

Mendimet i kam pasur këto ditë, sepse luaj një ndeshje në tri ditë. Do të ndryshojë diçka për një lojë të mirë. Shpresoj të bëjmë zgjedhjet e duhura.

**Do të jetë Agolli në fushë?**

Ai është kapiten, sepse ka më shumë ndeshje se të gjithë. Nesër (sot) do të shohim nëse do të luajë. Ai ka punuar shumë mirë.

**Në Skoci do të kënaqeshit vetëm me një barazim?**

Kemi ardhur në Gllasgou për të bërë më të mirën dhe për të kërkuar fitoren. I dimë të metat dhe përparësitë tona pozitive. Do të luajmë ndaj një skuadre të "plagosur" në një ambient të vështirë, që ka humbur 4-0 me Belgjikën. Do të bëjmë më të mirën për të marrë fitoren. Do ta tentojmë. Pas ndeshjes do të flasim nëse do të jemi të kënaqur me një pikë.

**Herën e fundit që keni qenë këtu keni shënuar golin fitues me Italinë...**

Ka qenë një nga ditët më të bukura të karrierës sime, kam shënuar, por tani jam trajner i Shqipërisë. Të luash kundër Skocisë nuk është asnjëherë e lehtë, sidomos pas humbjes me Belgjikën. Krenaria skocezeve duhet respektuar. Do të tentojmë të kthejmë situatën në favorin e tyre.

**A do të ndryshojë qasja e skuadrës krahasuar me ndeshjen me Izraelin?**

Nëse bëjmë gabimet e pjesës së parë me Izraelin, do të jetë fatale për ne. Duhet të jemi shumë më të përgjendur për të mos kryer asnjë gabim.

**A mendoni që qendërmbrojtësit do të jenë më mirë në këtë sfidë, fjala është për**



**Gjimshitin dhe Veselin.**

Veseli dhe Gjimshiti kanë bërë një ndeshje të mirë, gabimet ishin vetëm teknike. Më kanë bindur me formën e duhur.

**Fakti që Gjimshiti është shtatllartë i jep përparësi...**

Do të mbrohem në të gjitha mënyrat dhe duhet të jemi të përgatitur në të gjitha situatat, sepse Skocia sulmon dhe kundërsulmon me shpejtësi.

**Çfarë ju bëri të ndryshonit mendim për Kaçen?**

Na është dëmtuar Lila. Kaça ka pasur një dëmtim, nuk ka luajtur në tri ndeshjet e fundit. Do të jetë në stol, ndoshta për të na dhënë ndihmë në pjesën e dytë.

**Grumbullimi i Kaçes u mor vesh nëpërmjet rrjeteve sociale, s'do të ishte më serioze sikur të jepej një njoftim zyrtar?**

Sot bota rrotullohet nga rrjetet sociale. Çfarë mund të them, nuk e kam postuar unë në "Instagram". Faji në këtë rast është i zyrës së shtypit.

**A është Shqipëria favorite e grupit?**

Nuk jemi favoritet, jemi në të njëjtin nivel me tri skuadrat. Të shpresojmë që të marrim rezultat pozitiv me Skocinë. Për të fituar grupin duhet derdhur shumë djersë.

**Kemi ardhur në Gllasgou për të bërë më të mirën dhe për të kërkuar fitoren. I dimë të metat dhe përparësitë tona pozitive. Do të luajmë ndaj një skuadre të 'plagosur' në një ambient të vështirë, që ka humbur 4-0 me Belgjikën. Do të bëjmë më të mirën për të marrë fitoren. Do ta tentojmë. Pas ndeshjes do të flasim nëse do të jemi të kënaqur me një pikë.**

**IKËN ANDI LILA, VJEN ERGYS KAÇE**

Një federatë për turp, lojtarët hyjnë e dalin pa të keq në listë

Vazhdojnë çudirat me Kombëtaren, por edhe me FSHF-në! Të gjitha mediat e marrin vesh nëpërmjet Ergys Kaçes, që grumbullimin apo rithirrjen në

Kombëtare e tregon vetë nëpërmjet postimit në "Instagram"-in e tij. Ndërkohë, pak minuta më parë, i pyetur për rikthimin e Kaçes, se pse është mbajtur i fshehtë dhe nga ana e FSHF-së nuk ka pasur asnjë komunikim zyrtar, trajneri Kristian Panuçi, thotë se e ka thirrur sepse nuk ka gati Andi Lilën. Dashur pa dashur, trajneri Panuçi del bluf, sepse edhe për Andi Lilën askush nuk e di pse nuk është në grumbullim për ndeshjen e sotme ndaj Skocisë. Kjo tregon edhe njëherë një mungesë të theksuar serioziteti në Kombëtaren tonë. Ndërkohë, trajneri Kristian Panuçi, në konferencë thotë se nuk është faji i tij, por i kalon "topin" FSHF-së dhe shefit të marrëdhënieve me shtypin, Gerti Çarçanin. "Pyesi Çarçanin, e ka ky fajin, nuk e kam unë që nuk është publikuar në media për largimin e Grezdes".

500 tifozë shqiptarë në Skoci, ja çmimet e biletave Shqipëria do të përballë në "Hampden Park" të Gllasgou me Skocinë në takimin e vlefshëm për Grupin 1 të Ligës C. Pas triumfit në "Elbasan Arena" ndaj Izraelit, djemtë kuqezinj do të kërkojnë një tjetër rezultat pozitiv në Ligën e Kombeve. Në stadium priten rreth 20 mijë tifozë skocezë dhe afro 500 shqiptarë. Biletat për të

**KOMBETARJA**

Vazhdojnë çudirat me Kombëtaren, por edhe me FSHF-në! Të gjitha mediat e marrin vesh nëpërmjet Ergys Kaçes, që grumbullimin apo rithirrjen në Kombëtare e tregon vetë nëpërmjet postimit në "Instagram"-in e tij. Ndërkohë, pak minuta më parë, i pyetur për rikthimin e Kaçes, se pse është mbajtur i fshehtë dhe nga ana e FSHF-së nuk ka pasur asnjë komunikim zyrtar, trajneri Kristian Panuçi, thotë se e ka thirrur sepse nuk ka gati Andi Lilën.

syeshme për të gjithë futbolldashësit që jetojnë pranë Skocisë.

**KAPITENI RRËFEN MENDIMIN PËR BINAKUN**

Agolli: Kam dhënë maksimumin, nuk e di kë do të zgjedhë trajneri

Kapiteni Ansi Agolli ishte i pranishëm në konferencën për shtyp së bashku me trajnerin Panuçi, ku foli për sfidën e nesërme ndaj Skocisë, të vlefshme për Ligën e Kombeve. Mbrojtësi tregoi se dëshira e tij, si e çdo lojtari është të luaj titullar, por gjithsesi e rëndësishme është që skuadra të marrë rezultat pozitiv. 35-vjeçari nuk nguroi të komplementonte edhe debutimin e Binakut dhe Gavazajt me fanellën e Kombëtares.

**Të vjen keq që del në konferencën për shtyp si kapiten, por nuk je në fushë?**

Nuk më vjen keq që jam në konferencë. Çdo kapiten e ka për detyrë të vijë këtu. Trajneri e tha mjaft saktë, nuk kam çfarë përsëris. Normalisht që çdo lojtari vjen në ekipi kombëtar për të luajtur. Zgjidhjet i bën trajneri. Rëndësi ka që skuadra të ecë përpara dhe nesër të marrë rezultat pozitiv.

**Ka luajtur kundër Sëllitikut me Karabakun, a u ke transmetuar shokëve të skuadrës në lidhje me atmosferën?**

Shokët e skuadrës e kanë parasysh çfarë atmosferë do të jetë nesër në stadium. Do jetë mjaft e mirë për çdo futbollist që do të luajë nesër në stadium. Duhet ta shfrytëzojmë pozitivisht në lojë dhe të japim më të mirën.

**Formacioni nuk bëhet i ditur, a do të jesh në fushë?**

Kam bërë maksimumin tim. Besoj jam në një formë të mirë. Nuk e di, trajneri e tha që akoma nuk është zgjedhur formacioni, le të presim. Shpresoj të jem.

**Çfarë mendimi ke për Binakun?**

Mendoj që ka bërë paraqitje mjaft të mirë. Më bëri përshtypje adaptimi me grupin në një kohë mjaft të shkurtër. Kjo është diçka pozitive. Po kështu edhe Gavazaj, sepse edhe ai e kishte ndeshjen e parë. E kaluan ketë provë. Fjalët janë mjaft pozitive.

fozët shqiptarë që do të jenë të pranishëm për të përkrahur Kombëtaren në "Hampden Park" do të kushtojnë nga 5 deri në 30 paund. Çmimet tepër të ar-



LIGA E KOMBEVE



Danimarka ka kaluar disa ditë kaosi në fushën e futbollit, për shkak të zënkave mes futbollistëve dhe presidentit të Federatës të Futbollit të Danimarkës. Yje si Eriks-

en, Jusuf Poulsen, Shone, Kristensen dhe disa të tjerë dolën kundër federatës, për shkak se ajo u ka prishur imazhin dhe i ka akuzuar për mashtrim publik. Kjo situatë kaotike duket se është zgjidhur dhe yjet danezë u rikthyen në kombëtare dhe impakti i tyre ishte i menjëhershëm. Ylli i Tottenham, Kristian Eriksen shënoi të dy golat në fitoren kundër Uellsit 2-0.

Danimarka gjunjëzon Uellsin, Bejl: Gjyqtari na vodhi

AKUZAT E BEJL

Ylli i Real Madridit dhe i Uellsit, Gareth Bejl u pa shumë i zhgënjyer nga humbja kundër Danimarkës. Në fjalën e tij pas ndeshjes, 28-vjeçari tha: "Jemi të zhgënjyer me humbjen kundër Danimarkës. Donim ta fito-

nin këtë ndeshje, si të gjitha ndeshjet ku unë me shokët e mi të skuadrës zbrisim në fushë. Jam krenar gjithsesi, pasi luftuam shumë kundër një kundërshtari të fortë. Jemi në proceset e para të një projekti të ri dhe duam që të përmirësohemi nga

ndeshja në ndeshje. Ka gjëra pozitive që mund të marrim nga ky takim. Arbitri gaboi, pasi penalltia nuk ishte. Undikua nga tifozët dhe e them me plot bindje se nëse do të ishim në Uells, as nuk do ta mendonte për ta akorduar. Gjithsesi, mbaroi ky takim dhe të shohim për ndeshjen e ardhshme, ku objektivi është pa diskutim vetëm fitorja".



Jeton Selimi



Mbape dhe Zhiru çojnë "gjelat" te fitorja. Italia luan shansin e radhës kundër Portugalisë

Kampionët e botës, shumë të fortë për Holandën

Alioski nderon Maqedoninë ndaj Armenisë



Liga e Kombeve ka vijuar me përballje tepër interesante, teksa Francë-Holandë u mbyll në rezultatin 2-1. Pas barazimit në transfertë ndaj Gjermanisë, kampionët e botës gjejnë fitoren përballë skuadrës së Kuman. Për "tulipanët", kjo ishte sfida e parë në Ligën e Kombeve, ku Mbape e Zhiru vulosën suksesin e bluve. Qipro-Sloveni u mbyll në 2-1 dhe Lihtenshtein-Gjibraltar 2-0. 2 Për sa u përket takimeve të luajtura në orën 18:00, kanë triumfuar të gjitha ekipet vendëse. Danimarka mposht Uellsin me rezultatin 2-0, Bullgaria "surprizoi" Norvegjinë duke e mposhtur 1-0. Ndërkohë që Maqedonia dominoi ndaj Armenisë, duke e mposhtur 2-0 me 5 lojtarë me origjinë shqiptare në fushë. Bëhet fjalë për Musliun, Bejtullain, Elmazin, Bardhin dhe Alioskin. Ky i fundit shënoi edhe golin e parë me penallti. Sfidat Gjeorgji-Letoni përfundoi me rezultatin 1-0. Në orën 15:00 u zhvillua sfida mes Ukrainës dhe Sllovakisë, që përfundoi me rezultatin 1-0 në favor të skuadrës së Shevchenkos.

SOT ITALI-PORTUGALI

Italia vazhdon të jetë një skuadër në agoni. Moskualifikimi në Botëror u shoqërua me largime dhe ndryshime nga drejtuesit e federatës së futbollit, tek trajneri dhe lojtarët. UEFA Nations League konsiderohej se do të

ishte fillimi i një cikli të ri dhe premtues, por në fakt ndeshja e tyre e parë në Bolonja kundër Polonisë nuk rezultoi e tillë. Një barazim i arritur falë një penalltie, një skuadër që ende nuk arrin të shfaqë më të mirën e saj. Ndalesa e radhës në Ligën e Kombeve do të jetë transfertë kundër Portugalisë, me këta të fun-

dit që kanë një mungesë të madhe siç është Cristiano Ronaldo. Luzitanët i dhanë lamtumirën Botërorit në fazën e 1/8 në sfidën kundër Uruguait. Gjithsesi, skuadra po kalon një periudhë pozitive që prej Europianit "Francë 2016" të fituar prej tyre e deri në ndeshjet e tyre të fundit të shpërndara mes miqësoreve dhe sfidave të

Botërorit. Në 10 përballjet e fundit Portugalia regjistron vetëm 2 humbje, ndërkohë që barazimet janë rezultati më i shpeshtë që kanë siguruar plot 5 herë, teksa 3 janë fitoret. Në kampin tjetër, Italia njih vetëm një fitore në 8 ndeshjet e fundit, gjithsesi përballë Portugalisë janë të kaltrit që kanë një bilanc më pozitiv duke fituar 6 nga

NDESHJA

Italia vazhdon të jetë një skuadër në agoni.

Moskualifikimi në Botëror u shoqërua me largime dhe ndryshime nga drejtuesit e federatës së futbollit, tek trajneri dhe lojtarët. UEFA Nations League konsiderohej se do të ishte fillimi i një cikli të ri dhe premtues, por në fakt ndeshja e tyre e parë në Bolonja kundër Polonisë nuk rezultoi e tillë.

7 duelet e fundit, teksa luzitanët për këtë vit nuk kanë fituar asnjë ndeshje përballë një kombëtareje europiane. Tri pikët janë synimi i për-bashkët i të dy përfaqësuesëve, të kaltrit për t'i dhënë vetës pak optimizëm në një situatë aspak të këndshme, portugezët për të treguar se dhe pa Ronaldo, ata mund të fitojnë



Santos: Do habiteni sesa gola do të bëjë Ronaldo në Serinë A

Trajneri i Portugalisë, Fernando Santos foli në një konferencë shtypi për ndeshjen e Ligës së Kombeve kundër Italisë. "Aksurët" ndanë pikë me Poloninë në ndeshjen e parë të Ligës së Kombeve dhe janë gati të luajnë kundër Portugalisë për të marrë fitoren. Në fjalën e tij, Santos tha: "Ata nuk ishin në Kupën e Botës, por ndeshja kundër Italisë është gjithmonë e vështirë. Kundër Polonisë, në gjysmën e parë pashe që italianët po përpiqeshin. Tani Italia është e vendosur të tregojë vlerën e saj pas një Kampionati Botëror të humbur. Do të jetë një ndeshje e madhe, të dyja ekipet do të bëjnë më të mirën për të fituar. Pasi Baloteli u largua nga fusha dhe Kiesa zëvendësoi, ekipi i Mançinit kundër Polonisë ka ndryshuar mënyrën e lojës dhe ne do t'i kushtojmë vëmendje kësaj", - u shpreh Santos. Po ashtu, strategu portugez foli edhe për Kristiano Ronaldo: "Prisni dhe shikoni se sa gola do të shënojë në Itali. Serie A ka lojtarin më të mirë në botë dhe 3 ndeshje nuk e ndryshojnë këtë gjë".

NDIZET MERKATOJA

Zidan: Shumë shpejt do të drejtoj një ekip

Zinedin Zidan sapo ka rrihapur merkaton në Europë, atë të trajnerëve. Tekniku francez, në një prononcim për mediat spanjolle ka shtuar edhe më shumë zërat se është pranë rikthimit në pankinë, duke konfirmuar se së shpejti do të dëgjohej në reja rreth emrit të

tij. "Me siguri që brenda një kohe të shkurtër do të kthehem të trajnoj, pasi është ajo që më pëlgen dhe kam bërë gjithë jetën time", ishin fjalët e Zidan për TVE, i pikasur në një turne në Spanjë, ku po ndiqte një aktivitet të djalit të vogël, Eljaz, i cili trajnohet nga Çabi Alonso. Pa-

varësisht spekulimeve të muajve të fundit, kjo është hera e parë në të cilën Zidan pohon se është pranë rikthimit në pankinë, që pas largimit nga Real Madrid në fillimin e verës. Tekniku përfillet si zëvendësuesi më i mundshëm i Zhoze Murinjos në pankinë e Mançester Junajtit, por ka shumë skuadra të tjera të interesuara për francezin, nëse dëshirojnë planet që kanë nisur me teknikët aktualë.

PORTIERI

Kurtua rrëfen kalimin te Reali i Madridit



Portieri i Real Madridit, Tibo Kurtua, shpjegoi për "Sky Sports" se si ndjehet pas largimit nga Çelsi për t'u bashkuar me klubin spanjoll këtë verë. "Unë mendoj se në mars vendimi ishte marrë dhe mendova se klubi do ta pranonte atë. Pastaj për

shkak se transferimi ishte i mbyllur, nuk u paraqita në stërvitje, sepse mendova se

ishte më mirë të mos shqetësoja lojtarët dhe skuadrën". Kurtua gjithashtu donte të shpjegonte deklaratën e tij, kur tha se niveli të Real Madrid është më i lartë se të Çelsi. "Kurrë nuk kam menduar këtë. Unë vetëm thashë se ndoshta në stërvitje kjo shkon pak më shpejt, por kjo është edhe cilësia e Real Madrid. Gjithsesi, nuk mund të them se Çelsi nuk ka cilësi", - përfundoi Kurtua.

Dje në "Europa e lirë"

# "Trepça" në prag të falimentimit

Nga Luljeta Krasniqi - Veseli

(vijon nga faqja 1)

Kombinati metalurgjik "Trepça" aktualisht po përballet me vështirësi të mëdha të funksionimit, me nivel të ulët të prodhimit dhe me mosmenaxhim të duhur. E gjithë kjo situatë thuhet se po sjell ndërmarrjen në krizë dhe afër falimentimit. Ministri i Zhvillimit Ekonomik në Qeverinë e Kosovës, Valdrin Luka, thotë për Radion Evropa e Lirë se ka probleme në kombinatin metalurgjik "Trepça" dhe kjo do të vazhdojë edhe për një kohë. "Mentalisht 'Trepça' po kalon në një periudhë të vështirë. Ka problem me prodhim, ka probleme me kapacitete prodhuese, ka probleme me menaxhim, ka probleme me sindikatë. Edhe pse jemi mundur dhe kemi shikuar mundësitë e kapaciteteve prodhuese, por kjo nuk po ndodh në mënyrë të kënaqshme", thotë Luka. Ai shton si u kanë dhënë mundësitë menaxhmentit të "Trepçës", që së bashku me sindikatën t'i rishikojnë vendet e punës, që të lëvizin një pjesë të stafit nga ato pozita që janë të ndryshme dhe në mënyrë vullnetare t'i fusin në minierë, pasi që siç thotë Luka, "sa më shumë punëtorë në minierë, rezultojnë edhe me rritje të prodhimit". Afër dy vjet që nga miratimi i Ligjit për "Trepçën", ende nuk janë përmbyllur të gjitha procedurat për fillimin e rimëkëmbjes dhe zhvillimin e kombinatit. Kjo ndërmarrje - nënvizoi ministri Luka - është duke kaluar në procese të shumta ligjore dhe se beson që në muajin tetor të kalojë miratimi i statusit të "Trepçës" në Kuvendin e Kosovës dhe të regjistrohet si shoqëri aksionare. "Në momentin që kemi ardhur në qeveri, kemi shtuar dinamikën që të përfundojmë këtë aspekt ligjor, por kemi hasur në disa probleme mes sindikatës dhe bordit, ku rezultojë me një grevë nga sindikata. Por, jemi ulur dhe kemi arritur një pajtim që brenda tre muajve t'i zgjidhim ato problem. Komisionet për zgjidhjen e problemeve janë formuar para një muaj dhe janë në fillim të punës dhe kemi kohë që brenda dy muajve të arrihet marrëveshja", thotë Luka. Përfundimi i të gjitha proceseve ligjore me kombinatin "Trepça" - shton ministri Luka - do t'i hapë rrugë zhvillimit shumë më të lehtë të "Trepçës" përmes investime private kapitale. Minoriteti e "Trepçës" në muajin e korrik patën hyrë në grevë për disa ditë, për shkak të mospajtimeve që ata kishin pasur me draft-statutin e kombinatit "Trepça", të miratuar nga qeveria e Kosovës. Shyqri Sadiku, kryetar i sindikatës së "Trepçës", tha për Radion Evro-



pa e Lirë se institucionet kanë neglizhuar proceset për rimëkëmbjen e "Trepçës". Ai thotë se në formën si po menaxhohet "Trepça", po shkohet drejt falimentimit. Sadiku shton se për të gjitha këto probleme janë njoftuar institucionet kompetente, por askush nuk ka vullnet që të merret me zgjidhjen e tyre. "Trepça" që nga viti 2014 është


duke punuar me rënie të prodhimit, ka rënie drastike. Krahasuar vitin 2016 me vitin 2017, kemi gati për 27 për qind më pak prodhim, kjo është shqetësuese dhe e kemi potencuar. Fatkeqësisht edhe viti 2018, krahasuar me vitin 2017 ka rënie. Për vitin 2018 vetëm në minierën e Stantërgut janë planifikuar prodhim 184 mijë tonë, por që ky

plan nuk realizohet më shumë se 60 për qind", thotë Sadiku. Sipas të dhënave zyrtare, nga viti 1945 e deri në periudhën para vitit 1990, miniera prodhonte rreth 600 mijë tonë xehe në vit. Kurse sot, nga aty nxirren më shumë se 150 mijë tonë xehe. Kombinati metalurgjik "Trepça" gjendet në komunën e Mitrovicës. Sektorët e tij gjenden në pjesën veriore

dhe atë jugore të qytetit. Përveç aseteve në Kosovë, 31 prona të këtij kombinati gjenden në republikat e ish-Jugosllavisë, duke përfshirë këtu fabrika, zyra dhe objekte tjera. "Trepça" ishte në mesin e ndërmarrjeve më të mëdha në ish-Jugosllavi, por që nga pas luftë është përballur me probleme të shumta, që asnjëherë nuk arriti të rimëkëmbet.



**Fjalëkryqi (1)**



**HORIZONTAL**

1. Janë kapakë me tituj.
8. Debat pa kufij
11. Sherif aktor.
12. Kapen në kufij.
13. Egoyan regjisor.
14. Para Angeles.
16. Bshen duke përzënë.
19. Nota e diapazonit.
21. Gjysmë shtopi.
23. Një ndreqje.
25. Falsë pa fe.
27. Ata izraelitë të vendosur në rripin e Gazës
29. Në krye të masave.
30. Janë ata që jetojnë në kurriz të të tjerëve.
32. Janë poezi.
34. Eshhtë vend si Katar.
35. Eshhtë prifti.
37. Ishite miku i Eneas.
39. Në fund majtas.
41. O' Hara që qe aktore.

42. Treni pa cifte.
44. Mund të jenë edhe ushtarake.
46. I ka rrënjët nën tokë.
47. Një shtet aziatik.
48. Një sportist në pistë.
51. Një pjesë e kilometrave.
52. Makeba që qe këngëtare.
53. Ishin kapot kozakë.

**VERTIKAL**

1. Nget edhe ajo e mirë.
2. Në mes të dhomës.
3. Rruga e famshme e Ferenc Molnar.
4. Ramazzotti këngëtar.
5. Kufizojnë një truk.
6. Pak industriale.
7. Janë bardhoshët
8. Janë baballarët.
9. Janë periodike si revistat.
10. Në mes të dramës.
13. Eshhtë diletant.
15. Janë ashkla për të ndezur zjarrin.
17. Kështu janë filmat me drita të kuqe.
18. Piper pa kufij.
20. Janë malet si Jezerca.
22. Mund të jetë fotografie.
24. Janë provat që administrohen.
26. Njëri nga Frashërlinjët e famshëm.
28. Janë për të lidhur.
31. Fund janari.
33. Fillojnë daljen.
35. Futen pa fe.
36. Një personal për gjuajtje të lira.
38. Ishin rapsodë të akejve.
40. Eshhtë veshje indiane.
41. Një dëshirë fikse.
42. Eshhtë kapriçjo, trill.
43. Një Pasha i famshëm i Gjermanisë.
45. Hidhet një për shesh.
48. Tamam në fund.
49. Fillojnë largimin.
50. Fillojnë tatëpjetën.


**Fjalëkryqi (2)**

**HORIZONTAL**


1. Eshhtë fotografi i fotove të skandaleve.
10. Hidhen të parat.
12. Eshhtë vendi aderesues.
13. Mund të bëhen cash
16. Eshhtë qytet italian.
18. Janë sportistët që bëjnë stil të lirë.
19. Tre të parat në atletikë.
20. Gjysmë sahati.
22. Mbarojnë në finish
23. I ka tek stemat.
24. Kështu janë njerëzit e pererë.
26. Eshhtë pasuri edhe në natyrë.
27. Janë mashtrimet elektorale
28. Pak aromatike.
30. Mbyllin flatrat.
31. Chaney që qe aktor.
32. Eshhtë zeri... i hekurit.
35. Një e përditshme prestigjioze britanike.
37. Role pa zë

**VERTIKAL**


1. Irene aktore.
2. Ishin mallkime shkëhëruese
3. Ajo e zezë e futbollit është Pelé
4. Atmosferë e shkurtër.
5. Janë tek në rrasa.
6. Në krye të armatës.
7. Kufizojnë një zdap
8. Organizma Autonome Ndërkombëtare.
9. Eshhtë ushtarak i ulët.
10. Ishite vetëvrasja e samurait.
11. Eshhtë muaji gusht.
14. Janë për të trembur fëmijët.
15. Një veshje indiane.
17. Eshhtë i pashpirt.
20. Mund të kthehet në shkumë.
21. Fillojnë për të zbardhur krimin të tilla.
24. Një pallto ushtarake
25. Janë lojërat në video.
26. Një pjesë e kilometrave.
27. Fshehin fytyrat.
28. Në mes të Edgar dhe Poe.
29. Ka tetë këngëtarë.
33. Ai i shtatë është kinemaja.
34. Nolde piktor.
36. Femra pa fe.
39. Eshhtë lloj papagalli.
40. Një pjesë e pelegrinazhit.
41. Mund të këhëhet në stuhi.
42. Metheny kitarist.
44. Në krye të bashkisë.
45. Kastile janë në fund.
46. Inicialta e Rohmer, regjisor.



**Gjeni ndryshimin**



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

**SUDOKU**

2	8	3			6
		4			8
		7	9	3	
	3				2
6			2	1	5
7	1	8			
	7	4			
9	4		6		
3	6	2		5	

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

**Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar**

3	9	1	7	4	5	8	2	6
5	2	8	9	6	1	3	7	4
4	6	7	8	2	3	9	5	1
2	4	5	3	9	8	6	1	7
6	7	9	1	5	2	4	8	3
8	1	3	4	7	6	5	9	2
9	3	2	5	1	4	7	6	8
1	5	4	6	8	7	2	3	9
7	8	6	2	3	9	1	4	5

**KRIPTOSKEME**

**KRIPTOSKEME**  
Përgjigja e numrit të djeshëm

13	2		10	16	7	12	1	7					
14	7	10	16		4	9	11	10					
2	A	5	7	1	8	6	8	13	5	3	6	7	
6	R	10		15	7	10	9	1	2	12	9	11	
1	K	5	7	10	9	1	3	15	4	7	6	7	
11	8	11	12	4	15	17				3	12		
16	8	9	7	2	7	10	7			13	4		
9	17	2			12	3	4	9	11	9		9	
10	9	4	2	6	7			19	9	4	2		
9	1	3	12	2	4			1	2	10	2	11	2
11	2	11		19		2	12	4	9	1		4	
9		7	6	3	12	9	1		3	2	17	9	

F	O	K	A	T	B	U	R	I	M	E	T
I	R	A	K	F	O	R	A	R	I		
S	P	I	L	O	T	E	T	M	N		
P	I	R	A	T	E	T	A	T	A	K	
P	I	T	A	G	O	R	A	M	L	A	
E	S	U	U	G	O	F	A	R			
R	T	L	N	R	R	A	R	E	N	A	
B	A	L	A	A	E	T	O	P	A	T	
A	T	I	T	F	B	A	A	L			
L	M	A	E	E	L	A	R	T	E		
L	U	I	S	T	A	L	E	N	T	E	T
E	A	I	T	A	I	T	E	M	E		

*Argëtim filozofik*

- Ndonjëherë ne ndërtojmë mure, jo për të mbajtur njerëzit jashtë, por për të parë se kush interesohet mjaft për prishjen e tyre.
- Miku i të gjithëve nuk është miku i askujt.
- Jeta është një trëndafil, ku çdo petal është një iluzion dhe çdo gjemb është një realitet.
- Mos u'a thuaj miqve tuaj atë që armiqit tuaj nuk duhet ta dinë.
- Shëmnia është superior ndaj bukunisë në një pikë: kohëzgjatja.

*Thënie të mençura*

- Bëje jetën tënde një ëndërr, dhe ëndërrën tënde realitet.
- Plaga që të krijon miku kurrë nuk shërohet.
- Kemi tri kategori të miqve: ata që janë indiferentë, ata që janë të pakëndshëm dhe ata që urrëjmë.
- Forca e njeriut tregohet në fatqësi,
- besnikëria e mikut në fortunë.
- Ata që e kanë mënyrën e tyre, besojnë se më e rëndësishme në botë është dashuria. Të varfërit dinë se është paraja.

**PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR**

R	E	S	H	A	T	M	I	S	T	E	R	E		
F	R	A	P	E	S	I	T	U	D	O	R			
M	I	T	U	R	A	N	D	O	T	M	O			
A	R	M	A	N	D	A	L	E	S	A	T			
R	O	F	E	D	E	R	A	L	E	I				
S	T	D	E	K	O	R	A	T	A	D	K			
H	E	R	E	T	I	K	E	A	A	E				
I	E	T	A	P	A	T	P	A	L	M				
I	M	C	L	A	R	E	N	P	O	S	T	A	R	I
I	A	R	E	T	S	I	R	T	A	R	I			
I	N	D	E	S	A	M	A	T	O	R	E	T		
R	A	M	S	E	R	A	F	I	N	E	T			

**FJALËKRYQI (1)**

C	A	P	O	N	E	K	S	K	A	F	I			
O	D	I	N	I	P	O	R	R	R	V				
R	A	S	A	B	I	M	E	S	T	R	A	I		
R	K	M	I	L	I	M	E	T	R	I				
I	T	M	O	N	O	T	O	N	I	A	O			
D	E	L	I	K	A	T	E	A	K	T	E	T		
A	N	E	T	A	R	E	T	T	E	N	T			
P	D	O	S	E	T	B	O	U	Z	O				
L	O	H	A	N	Z	E	M	E	R	I	M			
A	R	E	N	A	T	E	T	E	A	R				
K	A	P	I	T	A	L	E	T	S	I	T	A		

**FJALËKRYQI (2)**



maiora premunt / gjëra të mëdha na presin

# TRANSFEROHU NË UET

MUNDËSIA E DYTË PËR NJË EDUKIM CILËSOR

**DATA 03-13 Shtator 2018**

- Juridik i Përgjithshëm
- Financë & Bankë
- Menaxhim Biznesi
- Informatikë Ekonomike
- Shkenca Politike
- Marrëdhënie Ndërkombëtare
- Psikologji
- Sociologji – Antropologji Sociale
- Komunikim – Marrëdhënie Publike
- Komunikim Dizajn

Adresa: Bulevardi Gjergj Fishta, Nd. 70, H.1, Tirane, Cel. 068 20 16 816, info@uet.edu.al, www.uet.edu.al



## www.gsh.al

# GAZETA SHQIPTARE



- Na mermi!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

# Gazeta e gjithë shqiptarëve!



Kontakt: +355 68 40 63 842

- Facebook: Gazeta Shqiptare
- Instagram: gazetashqiptare.al
- Twitter: Gazeta Shqiptare
- E-mail: gazetashqiptare.al@gmail.com
- Youtube: Gazeta Shqiptare

